



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 12 DHJETOR 2012**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 12. DECEMBRA 2012. GODINE**

**DHJETOR - DECEMBAR
2012**

Rendi i ditës

1. Informimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës nga kryeministri i Kosovës, z. Hashim Thaçi, për takimin e tretë të zhvilluar në Bruksel me kryeministrin e Serbisë

Dnevni red

1. Informisanje Skupštine Republike Kosova od strane Premijera Kosova, g. Hashim Thaçi, o održanom trećeg susreta u Briselu sa premijerom Srbije

Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti

KRYESUESI: Të nderuara zonja deputete dhe zotërinj deputetë,
I nderuar zoti kryeministër,
Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Për këtë mbledhje e kemi vetëm një pikë të rendit të ditës, dhe atë:

1. Informimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës nga kryeministri i Kosovës, zoti Hashim Thaçi, për takimin e tretë të zhvilluar në Bruksel me kryeministrin e Serbisë

Kryeministri i Republikës së Kosovës, zoti Hashim Thaçi, ka shprehur gatishmërinë për ta informuar Kuvendin e Republikës së Kosovës për takimin e tretë që e ka zhvilluar me kryeministrin e Serbisë në Bruksel, me ndërmjetësimin e përfaqësueses së lartë të Unionit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri, baroneshës Ketrin Eshton.

E ftoj kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Hashim Thaçi, që ta marrë fjalën. Urdhëroni!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuari nënkryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës,
I nderuari Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë,
Të nderuar qytetarë të Kosovës,
Zonja e zotërinj,
Fillimisht dëshiroj të ju falënderoj të nderuar deputetë dhe Kryesi e Kuvendit të Republikës së Kosovës për mirëkuptimin që keni treguar në kërkesën time për ta informuar Kuvendin e Kosovës për takimin e tretë të radhës që është zhvilluar në Bruksel ndërmjet dy kryeministrave të Kosovës dhe atij të Serbisë, me ndërmjetësimin e baroneshës Eshton.

Më lejoni të ju informoj për konkluzionet nga takimi i tretë i dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërshtetërore ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë.

Edhe në këtë takim, çështja kryesore që është diskutuar ka qenë zbatimi në praktikë i Marrëveshjes për Menaxhimin e Integruar të Kufijve ndërmjet shtetit të Kosovës dhe Serbisë.

Ne të gjithë jemi të vetëdijshëm se kjo çështje është jashtëzakonisht e rëndësishme, meqë përfundimisht e përkufizon në praktikë sovranitetin dhe integritetin territorial të Republikës së Kosovës, dhe e normalizon punën e të gjitha shërbimeve që bëhen në pikat kufitare me Serbinë.

Më lejoni që të ju informoj, siç edhe jeni në dijeni, se implementimi i marrëveshjes së IBM-së ka filluar dy ditë më parë, ka filluar suksesshëm, pra kanë filluar së funksionuari në kuptimin edhe de jure dhe de facto pikat kufitare ndërmjet shtetit të Kosovës dhe Serbisë

Zbatimi i Marrëveshjes për Menaxhimin e Integruar të Kufijve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë, në pikëkalimin kufitar në Jarinjë, porta 1, dhe në pikëkalimin në Merdar, tashmë veç ka filluar dhe është funksionalizuar.

Është një sukses i këtij dialogu për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve tona, është një kriter dhe standard evropian dhe po ndodh për herë të parë në relacionin Kosovë-Serbi.

Në dy pikat tjera kufitare, ajo në Bërnjak dhe te Dheu i Bardhë, zbatimi i IBM-së do të përfundojë në përfundim të muajit, pra deri më 31 dhjetor.

Me këtë rast, unë dua të ju bëj thirrje publike gjithë qytetarëve, në veçanti komunitetit serb, të cilët jetojnë në pjesën veriore të Kosovës, që ta kuptojnë drejt procesin e zbatimit të IBM-së, që është në shërbim të të gjithë qytetarëve, të rendit dhe ligjit, të perspektivës evropiane të të dyja vendeve tona, dhe gjithë rajonit.

Vendosja e kontrollit në pikat kufitare me Serbinë dhe ofrimi i shërbimeve doganore dhe atyre tjera përcjellëse sipas praktikave më të mira evropiane, është një moment jashtëzakonisht i rëndësishëm.

Kjo do të mundësojë luftimin e dukurive negative, që kanë qenë të pranishme në atë pjesë të territorit të Kosovës tash e 13 vjet, luftimin e kontrabandës, dhe mbi të gjitha do të mundësojë qarkullimin normal për qytetarët dhe për mallrat.

Qytetarët që jetojnë në veri të Kosovës duhet të bashkëpunojnë me të gjitha agjencitë qeveritare, me qëllim që të evitohen problemet e mundshme që mund të nxiten nga grupe të ndryshme të interesit, të cilat janë kundër vendosjes së rendit dhe ligjit në atë pjesë të territorit të Republikës së Kosovës.

Çështja e dytë që është adresuar është arritja e marrëveshjes për hapjen e zyrave ndërlidhëse të Republikës së Kosovës në Beograd dhe të Serbisë në Prishtinë.

Pra, në takimin e përbashkët që e kemi zhvilluar, fillimisht është zhvilluar një takim me baroneshën Eshton, ku kam qenë së bashku me zëvendëskryeministren Edita Tahirin dhe koordinatorin politik, Blerim Shala. Është arritur marrëveshja për hapjen e zyrave ndërlidhëse në dy shtetet respektive. Prandaj, zëvendëskryeministren Edita Tahiri dhe zotin Shala i falënderoj për punën dhe përkushtimin dhe përgjegjësitë e tyre.

Pra, Republika e Kosovës do ta ketë zyrën e saj ndërlidhëse në Beograd, dhe Serbia do ta ketë zyrën ndërlidhëse në Prishtinë.

Jemi pajtuar që në fazën e parë, zyrat ndërlidhëse në dy shtetet respektive, për shkaqe tashmë të njohura, sidomos atyre të sigurisë, të vendosen në ndërtesat e misionit të Bashkimit Evropian në Prishtinë dhe në Beograd.

Me këtë rast, unë dëshiroj që edhe një herë ta falënderoj baroneshën Eshton, që në emër të Bashkimit Evropian ka pranuar që Zyra Ndërlidhëse e Kosovës të vendoset në të njëjtën ndërtesë të misionit të Bashkimit Evropian në Beograd.

Sa i përket afatit kohor të emërimit të zyrtarëve që do t'i udhëheqin këto zyra ndërlidhëse, ne jemi pajtuar që kjo të bëhet deri kah fundi i muajit dhjetor 2012.

Ne kemi vendosur që në Zyrën Ndërlidhëse të Republikës së Kosovës në Beograd ta emërojmë një nga ambasadorët aktualë të Republikës së Kosovës.

Mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe fetare ka qenë një prej pikave tjera që e kemi diskutuar në takimin me baroneshën Eshton dhe kryeministrin Daçiq. Gjithashtu i kam informuar për vendimin që e kemi marrë, që Policia e Kosovës të themelojë njësi të veçantë multietnike, në kuadër të saj, e cila do të marrë në mbrojtje fizike ruajtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore dhe religjioze serbe që ndodhen në Kosovë. E gjithë kjo është plotësisht në përputhshmëri me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës, dhe dokumentet tjera bazë për shpalljen e Kosovës së pavarur dhe sovrane.

Pikë tjetër ka qenë transparenca e ndihmës financiare të Serbisë për serbët që jetojnë në Kosovë.

Në takimin e tretë e kemi adresuar edhe çështjen e financimit që Serbia i bën për serbët që jetojnë në Kosovë tash e 13 vjet.

Natyrisht, thelbësore në këtë çështje është domosdoshmëria që këto fonde të jenë transparente dhe transferi i tyre të bëhet në mënyrë institucionale, për ato fonde dhe transfere që janë të përcaktuara qartë me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës dhe dokumentet tjera ndërkombëtare për pavarësinë e Kosovës, pra me dokumentin e presidentit Ahtisari.

Për këtë qëllim ne kemi diskutuar lidhur me mundësinë që të themelohet një fond i veçantë, i cili do të menaxhohet bashkërisht edhe me pjesëmarrjen e bashkësisë ndërkombëtare.

Esenciale është që në të ardhmen, të gjitha fondet që Serbia i parashikon si ndihmë për komunat me shumicë serbe në Kosovë do të jenë plotësisht transparente, dhe të transferohen në mënyrë legale në fondin e veçantë, i cili do të menaxhohet nga ne dhe bashkësia ndërkombëtare.

Në këtë çështje, ne ende nuk kemi arritur marrëveshje përfundimtare, sepse kjo çështje ndërlidhet drejtpërdrejt me domosdoshmërinë dhe urgjencën e shpërbërjes së strukturave ilegale të sigurisë së Serbisë, që ekzistojnë në veri të vendit.

Çështja e shpërbërjes së strukturave ilegale të Serbisë në Kosovë dhe financimi i tyre do të jetë një temë e veçantë, e cila do të diskutohet në takimin e radhës, që do të mbahet më 17 janar 2013. Së paku kështu është planifikuar.

Ndërsa, si gjithmonë, njëra nga pikat kryesore të takimit nga unë mbetet çështja e personave të zhdukur. E kemi shtruar problemin e moszbardhjes së fatit të personave të zhdukur dhe domosdoshmërinë që kjo çështje të zgjidhet njëherë e përgjithmonë.

Prandaj, jemi pajtuar që komisionet përkatëse ta intensifikojnë punën e tyre në shërbim të zbardhjes të fatit të atyre që mungojnë dhe nuk e dimë se ku ndodhen.

Duke ju falënderuar gjithmonë, ju ftoj për diskutimet tuaja, për t'iu përgjigjur edhe pyetjeve tuaja, që adresohen rreth kësaj problematike, por gjithmonë duke iu falënderuar për mbështetjen tuaj.

Unë sapo jam kthyer nga Brukseli, e kam informuar Kabinetin qeveritar, e kam informuar gjithë spektrin politik kosovar, dhe i falënderoj për durimin dhe mirëkuptimin e tyre që kanë treguar në informimin nga ne.

Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit zoti kryeministër! Radha është e kryetarëve të grupeve parlamentare, përkatësisht e të ngarkuarve për të folur në emër të grupeve.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, zoti Bajrami e ka fjalën.

ARSIM BAJRAMI: I nderuar nënkryetar i Kuvendit të Kosovës,
Zoti kryeministër,
Ministra,
Të nderuar kolegë deputetë,
Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e mbështet plotësisht informatën e kryeministrit dhe e quan si një praktikë të mirë kushtetuese, tanimë të instaluar informimin e drejtpërdrejtë të Kuvendit për rrjedhën e procesit.

Ne i mbështesim të gjitha pikat që i prezantoi kryeministri, që janë diskutuar dhe vlerësojmë se të gjitha janë me interes për Kosovën dhe të gjitha kanë bazë edhe në Rezolutën e miratuar, me të cilën është autorizuar Qeveria, që të fillojë procesin e normalizimit.

Sa i përket çështjes së parë, mendoj se kemi hapin e parë konkret, kemi rezultatin e parë konkret, fillimin e implementimit të Marrëveshjes për Menaxhimin e Integruar të Kufirit. Dhe, ky është një sukses i madh, sepse definitivisht tani po shihet se Serbia po e trajton kufirin e Kosovës si kufi shtetëror, pa marrë parasysh se si ajo e interpreton për çështje të konsumit të brendshëm, ai është kufi shtetëror dhe definitivisht po vendoset kufiri ndërshtetëror ndërmjet dy shteteve dhe po vendoset rendi, rregulli sa i përket lëvizjes së

njerëzve dhe mallrave, që ka qenë edhe një burim i vazhdueshëm i kriminalitetit apo i destabilizimit të Kosovës.

Dhe, ne urojmë që kjo praktikë evropiane e menaxhimit të kufijve ndërmjet dy shteteve, të jetë praktikë e të gjitha shteteve të Ballkanit dhe urojmë që edhe pjesët tjera të kufirit të Kosovës, edhe me shtetet tjera, dalëngadalë të hyjë në këtë model evropian, që është i ri edhe për Evropën, pra diçka që Evropa pretendon ndoshta ta bëjë në tërë Evropën Juglindore.

Kështu që ne jemi jashtëzakonisht të kënaqur që ky proces ka filluar të implementohet, përkundër zvarritjeve apo edhe përkundër hezitimeve të Qeverisë serbe, që të fillojnë ta implementojnë dhe jemi falënderues edhe ndaj Bashkimit Evropian, që ka ushtruar presion që definitivisht marrëveshjet e arritura të fillojnë të implementohen.

Edhe sa i përket çështjeve tjera, për të cilat kryeministri neve na raportoi, mendoj se është jashtëzakonisht e rëndësishme hapja e zyrës, shkëmbimi i përfaqësuesve të dy shteteve, që është edhe para prirje e përfaqësimit diplomatik, që është jashtëzakonisht e rëndësishme. Është iluzion që në këtë fazë të pritët që të bëhet përfaqësimi diplomatik i plotë, për shkak se Serbia ende nuk e ka njohur Kosovën, por ky është një hap, sepse ne do të kemi përfaqësuesin tonë zyrtar të Republikës së Kosovës, se siç tha edhe kryeministri, do të jetë nga radha e ambasadorëve më të mirë që ka Kosova e që do ta përfaqësojë Republikën e Kosovës në raporte me Republikën e Serbisë dhe anasjelltas, Republika e Serbisë do ta ketë përfaqësuesin e vet legjitim, i cili do të përfaqësojë Republikën e Serbisë në Kosovë.

Jemi të sigurt, se me kohë këto nivele do të ngritën dhe jemi të sigurt se do të ngritën në nivele diplomatike.

Sa i përket çështjes së tretë, çështja e menaxhimit të fondeve apo transparencë e fondeve. Ne e dimë që Pakoja e Ahtisaarit ka pasur mjaft dispozita, sa i përket transparencës së fondeve apo menaxhimit të fondeve. Dhe, kjo që ne dëgjuam nga kryeministri është në të vërtetë e ka bazën juridike tek legjislacioni i Kosovës, te Kushtetuta e Kosovës dhe te Pakoja e Ahtisaarit dhe ne kërkojmë, që vërtetë të ketë transparencë të plotë të fondeve që vijnë dhe të gjitha mjeteve, në mënyrë që të gjitha ato fonde të regjistrohen në Qeverinë e Kosovës dhe Qeveria e Kosovës të ketë njëloj monitorimi, sa i përket qoftë fondeve që akordohen si donacione ndërkombëtare, qoftë donacioneve që eventualisht i jep Serbia brenda bazës ligjore që i lejohet, të koordinohen dhe në ato fonde të ketë plotësisht transparencë.

Insistojmë që në vazhdimësi të ngritën edhe çështje që u përmendën si çështja e të pagjeturve, çështja e shpërbërjes së strukturave paralele dhe unë do ta këshilloja kryeministrin, që në takimet e ardhshme të japë një listë prioritare të çështjeve, të fillojmë ne të ndikojmë pak në imponimin e agjendës së këtyre takimeve. Jo gjithmonë Bashkimi Evropian të vendosë agjendën në tavolinë, po do ta këshilloja që ta bëjë një listë prej 10 çështjeve prioritare dhe ajo çështje t'i dorëzohet nga ana e Kosovës, si një kërkesë që në takimet e radhës, çështjet tona tani të vendosen, jo vetëm çështjet, sepse unë gjykoj se kjo

faza emergjente e procesit të normalizimit veç ka kaluar me vetë faktin që kanë filluar implementimet e marrëveshjes dhe tani kemi nevojë t'i shtrojmë në mënyrë të dinjitetshme si shtet, çështjet që janë interes i Republikës së Kosovës. Dhe, besoj që këtu duhet të jemi shumë më proaktiv, edhe si Qeveri, edhe si Parlament, që ne të diskutojmë ndoshta edhe si Parlament, çështjet që i mendojmë, renditjen e hapave që duhet shtruar drejt normalizimit të plotë të marrëdhënieve me Serbinë, sepse procesi i normalizimit me Serbinë është një proces, një proces i pandashëm, që nënkupton shumë veprime. Por, ne duhet të imponojmë agjendën e veprimeve që janë interes i Republikës së Kosovës.

Po e zëmë, nuk mund më të tolerojmë veprimin e strukturave kundërkushtetuese. Në qoftë se duam t'i relativizojmë raportet, në qoftë se kemi treguar vullnet të mirë si Republikë e Kosovës, atëherë ne duhet tash të vendosim edhe çështjet që janë interes i Republikës së Kosovës, ku e para është shpërbërja e të gjitha strukturave kundërkushtetuese dhe kundërligjore, që veprojnë në veri, funksionalizimi i pushtetit gjyqësor dhe hapat tjerë një nga një, në mënyrë që t'i ofrohemi, ndoshta edhe finales së procesit dhe t'i ofrohemi një dokumenti final, i cili na çon drejt normalizimit të plotë të marrëdhënieve me Serbinë.

Ajo që është kërkesë, besoj e të gjitha grupeve parlamentare, por edhe e Parlamentit, është kërkesë e drejtuar Bashkimit Evropian, që në raport me Kosovën të udhëheqë politikë konstruktive, sepse pala e Kosovës është jashtëzakonisht konstruktive. Janë inkurajuese lajmet që vijnë nga takimi i djeshëm i Brukselit, që Serbia nuk do të ketë përparime në Bashkimin Evropian derisa nuk është e vendosur, që sinjerisht të normalizojë raportet, sepse çfarëdo ledhatimi i mëtejshëm i Serbisë në proceset e integritetit evropian do ta dëmtonte esencialisht procesin që ne kemi filluar dhe është për t'u përshëndetur, sidomos qëndrimi i disa shteteve, që ishte transparent dhe që ka qenë në kontinuitet, që Serbisë nuk i besohet më në fjalë, po nga Serbia kërkohen vepra. Serbia duhet të tregohet se ka një orientim pro evropian dhe ai orientim pro evropian nuk do të jetë vetëm deklarativ, po duhet të veprohet si në rastin e procesit të fillimit të implementimit të Projektit të menaxhimit të integruar të kufirit. Dhe, ne kemi shpresa që Bashkimi Evropian në kontinuitet do ta monitorojë procesin e dialogut dhe do të udhëheqë politikë të njëjtë parimore ndaj dy shteteve dhe të dy shtetet në një mënyrë, do të jenë plotësisht me qasje të barabarta sa i përket progresit drejt integriteteve në Bashkimin Evropian.

Edhe një herë, po e përfundoj, ne e mbështesim këtë praktikë dhe jemi të sigurt se ky proces ka hyrë tanimë në kontroll të plotë parlamentar, sepse ne pas çdo takimi po informohemi. Kemi mundësi edhe të bëjmë vërejtje, dhe është mirë të bëhen vërejtjet, nëse ka pakënaqësi është mirë të bëhen vërejtje, por sa është mirë të bëhen vërejtjet është mirë të jepen edhe propozime edhe sugjerime, sepse ne e dimë që në këtë proces Qeveria ka një partneritet me Kuvendin, sepse jemi marrë vesh edhe me Rezolutë, që komplet procesi do t'i dorëzohet Kuvendit dhe ne do ta votojmë në fund rezultatin final, qoftë një marrëveshje, qoftë pako e marrëveshjeve, një rezultat final që neve si Kuvend, do të na bëjë plotësisht të sigurt se është ndërtuar konsensusi politik, që kërkohet në këtë proces. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, kryetari i grupit, zoti Beqiri.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne konsiderojmë si Lidhje Demokratike e Kosovës, që informatat që po jepen megjithatë nuk janë të mjaftueshme. Fakti që marrëveshjet apo të ashtuquajturat konkluzione, flas të mëhershme, ajo që ka të bëjë veçmas për Menaxhimin e Integruar të Kufirit, nuk janë të shkruara, së paku ne nuk po i shohim që janë të shkruara dhe nuk po na prezantohen. Kjo lë hapësirë për interpretime të ndryshme.

Marrëveshja për IBM-in ose Menaxhimin e Integruar të Kufirit, por edhe ajo për zyrat ndërlidhëse, është shumë e qartë që ndryshe po interpretohet nga pala serbe dhe ndryshe po interpretohet nga kryeministri Thaçi.

Nëse ato sigurisht nuk i shohim, ose në një të ardhme nuk na prezantohen të shkruara, vërtet shtrohet pyetja: cila është e vërteta, a po fshihet diçka nga ne dhe qytetarët tanë?

Këtu nuk mund të shtrohet pyetja se kujt t'i besohet. Nuk është punë ose çështje besimi, por është çështje faktimi dhe argumentimi, sepse është shumë e qartë, që ne më së paku, jo që dëshirojmë, por asnjëherë nuk e besojmë çfarë thotë pala serbe. Por megjithatë, këtë që e thotë pala jonë - kryeministri, duhet të na argumentohet dhe në një mënyrë kjo e demanton atë çfarë na vjen nga Serbia si fjalë, qoftë edhe gënjeshtër.

Ne na shqetëson fakti, për shembull, që edhe tash nuk patëm ndonjë informatë, po flas sepse qytetarët tanë, opinionin pyet si do të jetë puna e doganimit ose zhdoganimit të mallrave që hyjnë nga Serbia, çështja e dokumenteve, çështja e tabelave të makinave, flas për pjesën veriore, çështja e buxhetit, që thuhet se do t'i ndahet, gjegjësisht parave që do të na merren nga ajo që po e dëgjojmë, nga Buxheti i Kosovës? Po themi se do të na merren, sepse ashtu siç është prezantuar ose po interpretohet, ne fare nuk do të pyetemi për këtë, ndoshta vetëm do të hyjnë e do të dalin në Buxhetin e Kosovës.

Është shumë e qartë dhe do të duhej të ishte e tillë, që sistemi doganor i Kosovës të mbetet një dhe unik. Ne jemi që të përkrahet zhvillimi i asaj pjese të Kosovës, veriut të Kosovës, por jo vetëm i asaj pjese. Nuk duhet sigurisht, të ketë diskriminim edhe ndaj pjesëve tjera, komunave tjera, komuniteteve tjera dhe qytetarëve tjerë në pjesën tjetër të Kosovës.

Për çdo gjë, pra edhe për ndarje të buxhetit do të duhej, siç është rregull, siç është ligji, siç e përcakton Kushtetuta, të vendosë Kuvendi i Republikës së Kosovës. Ky Kuvend, nëse e sheh të arsyeshme të ndahen mjete, le të ndajë cilësdo pjesë, por jo në mënyrën se si po thuhet. Nëse s'është e vërtetë, ne dëshirojmë ta dimë që kjo nuk është e vërtetë, por edhe në një të ardhme të na argumentohet.

Sigurisht që për pika tjera, që janë më pak konkrete në realizim, sepse u përmendën disa nga to, sigurisht se herëve tjera do të themi edhe më shumë, i përmendi edhe zoti

kryeministër, por kësaj radhe ajo që është shqetësim i veçantë yni, është çështja e menaxhimit të integruar të kufirit, si hap sigurisht duhet përshëndetur, por ajo që është thënë vërtet lë hapësirë edhe për t'u shqetësuar shumë dhe vërtet, për të qenë shumë në skepsë se do të ketë sukses, aq më tepër nëse cenohet në një mënyrë integriteti, nëse mund të thuhet, ose pavarësia buxhetore e Buxhetit të Republikës së Kosovës.

Ne edhe në të ardhmen edhe tani, kërkojmë që të kemi më shumë informata, po e them edhe një herë, në qoftë se këto janë të plotfuqishme, fillojnë të realizohen në praktikë, nuk ka asgjë të keqe, këto t'i kemi nesër edhe të shkruara, pse jo edhe me ndonjë agjendë në të ardhmen, për aq sa varet nga ne. Se, ne e kemi të qartë, që jo gjithçka, po ndoshta edhe shumëçka s'varet as për agjendën nga pala e Kosovës aq më pak, por nga të tjerët që po e përcaktojnë edhe agjendën.

Ne kërkojmë, që me ngulm të respektohet Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe të respektohet Rezoluta e këtij Kuvendi. Ajo që aty parashihet le të jetë konform kësaj Rezolute dhe Kushtetutës dhe sigurisht se për LDK-në nuk do të jetë problem, që të jemi mbështetës të zhvillimit të normalizimit të marrëdhënieve, por assesi diçka që e cenon edhe Rezolutën edhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Diçka të tillë as s'kemi për ta përkrahur as s'e kemi përkrahur gjër më tani. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti kryeministër e ka fjalën, për sqarim shtesë.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Ismet Beqiri, për pyetjet që i ngritët, që t'ju sqaroj juve dhe t'ju ndihmoj edhe të tjerëve, që mund të kenë të njëjtat pyetje.

Mendoj se gjithçka është shumë e qartë. Ne do të respektojmë në plotësi Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Gjithçka është në përputhshmëri me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës. Ajo se kujt duhet t'i besohet, mendoj se duhet t'i besohet më së shumti vetë realitetit të krijuar nga marrëveshja e arritur për IBM-in dhe fillimi i funksionimit të pikave kufitare mes të shtetit të Kosovës dhe Serbisë. Tanimë, të gjithë e kanë parë dhe e përjetojnë edhe vetë qytetarët, kalimet e kufijve mes të shtetit të Kosovës dhe Serbisë dhe natyrisht, edhe instalimin e policisë dhe doganierëve të Kosovës.

Pra, ne do të funksionojmë si një zonë doganore, një sistem të drejtësisë, zinxhir komandues të Policisë së Kosovës. Gjithçka do të jetë në përputhshmëri me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës.

Sa u përket deklarimeve të Beogradit, ju e dini ata edhe kur u larguan, kur i detyruam të largohen nga Kosova, në qershor 1999, ata festonin dhe proklamnin fitore. Faleminderit!

Kështu që tash secili besoj se i beson realitetit dhe jo festave humbëse të Beogradit.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar "Vetëvendosje", zoti Kasolli e ka fjalën.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, i nderuar kryesues dhe të nderuar deputetë!

Zhvillimi i dialogut politik ndërmjet kryeministrit të Kosovës, Hashim Thaçi, dhe atij të Serbisë, Ivica Daçiç, po e demaskon vazhdimisht vetveten. Si i tillë ky dialog po tregon gjithnjë e më shumë se sa i dëmshëm është për Kosovën në të gjitha aspektet fundamentale.

Pasojat e tij negative po vërehen qartë, si në planin e brendshëm politik, në relacionet e Kosovës me Brukselin, ashtu edhe në suspendimin e mundësive të brendshme për të shtrirë sovranitetin shtetëror në gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Pra, kostoja e këtij dialogu, qoftë në planin politik, ekonomik dhe juridik, mbetet e shumëfishtë dhe me pasoja fatale vetëm për qytetarët e Kosovës. Mirëpo, fatkeqësisht, e tillë është sot politika zyrtare e Qeverisë së Kosovës. Ajo nuk preokupohet vetëm për qytetarët e saj, kështu, gjithnjë e më qartë, po demantohet teza se ky dialog është kusht i domosdoshëm për realizimin e agjendës evropiane për Kosovën dhe si i tillë, është mundësi e afrimit të Republikës së Kosovës drejt Brukselit. Përkundrazi, ai po dëshmohet si antiteza e këtyre pikësnyimeve politike.

Pra, rrugëtimi ynë drejt këtij objektivi politik dhe strategjik po dëmtohet fundamentalisht keq, pikërisht nga ky dialog. Në këtë kontekst, raportet e fundit zyrtare të cilat janë hartuar këto ditë nga entitetet politikëbërëse të Brukselit, për hir të dialogut tashmë nuk denjojnë ta specifikojnë as figurativisht integritetin territorial të Kosovës.

Pra, nëse më parë integriteti territorial i Kosovës konsiderohej si referencë e këtyre instancave vendimmarrëse e politike, tashmë qëllimisht apo rastësisht ka filluar të bjerret si një imperativ politik, për shkak të ndjeshmërisë që mbart kjo çështje.

Paradoksalisht, për herë të parë është harruar të përmenden edhe strukturat paramilitare dhe kriminale të MUP-it serb, të cilat operojnë në pjesën veriore të Kosovës e të cilat ndryshe quhen si struktura paralele. Në këtë mënyrë, anatemimi i kësaj çështjeje nga Brukseli e diskualifikon edhe një pretendim tjetër të Qeverisë së Kosovës mbi arsyeshmërinë e këtij dialogu.

Në vazhdimësi kjo Qeveri ka deklaruar, se me anë të dialogut politik, në fund të fundit, synohet shpërbërja e këtyre strukturave si dhe instalimi i rendit juridik dhe ligjshmërisë edhe në atë pjesë të territorit të Kosovës, mirëpo shkarja që vërehet në këto dokumente tregon se me anë të këtij procesi, në të vërtetë po negociohet legalizimi i këtyre strukturave në atë pjesë të Kosovës. Pra, në këtë mënyrë po negociohen modalitetet juridike dhe politike, të cilat kanë për qëllim përjetësimin e vet shtetit të Serbisë brenda territorit të Kosovës. Rrjedhimisht, në këtë mënyrë po dëmtohet në substancë sovraniteti i shtetit, si në planin e brendshëm ashtu edhe në të jashtëm.

Ndërkaq, ironia e këtij fakti vërehet në kushtet që i janë vënë Kosovës sa u përket relacioneve të vendit me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, që Kosova të ketë avancim në këtë drejtim pa ekuivokë, kërkohet që të plotësohen kushtet rrënjësisht tjera,

sikurse sundimi i ligjit, luftimi i korrupsionit, reformimi i administratës publike. Janë pikërisht këto sfera, siç dihet, ku kjo Qeveri e mbanë kampionin e degradimit. Rrjedhimisht, ajo edhe shndërrohet në shkaktarin kryesor të shkatërrimit të synimeve kolektive të kësaj shoqërie.

E përfshirë në një dialog me Serbinë, pa asnjë kusht të vetëm për të dhe e udhëhequr nga forca kryesore rrënuese e kushteve të brendshme të ligjshmërisë dhe kriterëve politike të demokracisë, Kosova ndodhet në një rrugë pa krye aktualisht, pasojat e së cilës do të ndjehen edhe për shumë vjet në vijim.

Prandaj, edhe kjo mënyrë e informimit të Kuvendit të Kosovës nga kryeministri i Qeverisë, mbi zhvillimin e dialogut pas çdo raundi bisedimesh po merr gjithnjë e më shumë nuanca groteske, sepse, sipas kësaj qasjeje, vetë Kuvendi po zhvishet nga çdo fuqi përmbajtësore. Për pasojë, Kuvendi dhe deputetët po ndodhen para një fakti të kryer, ku me këtë rast qëllimi themelor mbetet vetëm plotësimi i karakterit formal të demokracisë, por jo edhe ai përmbajtësor.

Po shtrohet pyetja, se pse po zhvillohet kjo farsë pseudo-demokratike? Nuk ka dyshim, se përveç shkaqeve propagandistike, logjika e kësaj maskarade politike ndodhet tek nevoja e fshehur që ka ky pushtet që jo të ndikohet nga Kuvendi, por që ta ligjërojë vetveten nëpërmjet tij.

Përfundimisht, nuk kemi pse befasonemi edhe kur dëgjojmë se si Ivica Daçiçi deklaroi në Bruksel, se i ka marrëdhëniet më të mira me kryeministrin e Kosovës, Hashim Thaçin, se sa me udhëheqësit e shtetit të Kroacisë. Por, ky paradoks në shikim të parë ndodh ngase udhëheqësit e Kroacisë e ndërtojnë sovranitetin e shtetit, e luftojnë korrupsionin e brendshëm, i plotësojnë kushtet bazike për integritet të vendit të tyre në strukturat e BE-së dhe në fund deklarohen se nuk do të takohen me apologjetët propagandistikë të një regjimi kriminal. Kështu, ky qëndrim dinjitoz i përfaqësuesve politikë të një shteti dinjitoz nuk korrespondon me ambiciet hegjemonike të kryeministrit të Serbisë. Ndërkaq, në anën tjetër, Qeveria e Kosovës shkon në negociata pikërisht me përfaqësuesit e këtij regjimi, e dëmton sovranitetin e vendit nga këto negociata, e thellon korrupsionin dhe si e tillë, e largon Kosovën gjithnjë e më shumë nga rruga e integritetit në BE. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Kasolli! Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të AAK-së, zoti Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Ajo që do të themi krejt sot, në emër të Aleancës është se ne besojmë se Qeveria e Kosovës duhet të jetë jashtëzakonisht agjile, që të insistojë në implementimin e të gjitha marrëveshjeve.

Besojmë se mos implementimi mund të ketë pasoja tepër të rënda, do të thotë duhet të ketë implementim të gjitha atyre që arrihen si marrëveshje, në mënyrë që procesi të mund të ecë më tutje.

Dhe, çështja e dytë është se Qeveria duhet të kujdeset, që publiku i Kosovës të jetë i informuar për ato që arrihen si marrëveshje. Është jashtëzakonisht me interes që askush të mos e ketë ndjenjën se diçka përpos asaj që shihet, është duke ndodhur. Do të thotë, janë dy kërkesa të sakta dhe mendojmë se nuk duhet të jenë problematike për Kosovën.

Ne, sikur edhe më përpara, vazhdojmë ta mbështesim dialogun, përderisa ai dialog çon në rezultate pozitive për interes të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kryetarja e Grupit Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, zonja Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Përshëndetje për Kabinetin Qeveritar,

Përshëndetje për deputetët!

Duke marrë parasysh se Kuvendi i Kosovës ka miratuar rezolutën, në të cilën obligohet kryeministri Thaçi, që të raportojë pas çdo takimi me kryeministrin e Serbisë, në Kuvendin e Kosovës. Ky është raportimi i tretë pas takimit të tretë të kryeministrit Thaçi me kryeministrin e Serbisë, me ndërmjetësimin e baroneshës Eshton.

Nga ky takim i kryeministrit dhe raportimi i kryeministrit në Kuvendin e Kosovës, mund të themi se kryeministri raportoi që ka pasur katër pika, në të cilat është bazuar takimi i dy kryeministrave, së bashku me baroneshën Eshton.

Mund të themi, se si pikë e parë, apo si pikësypnim i parë i zbatimit të marrëveshjes teknike, në mes të Kosovës dhe Serbisë, zbatimi i IBM-it në mes Kosovës dhe Serbisë, është parë si çështje e rëndësishme dhe është çështje e rëndësishme edhe për sovranitetin dhe integritetin e Kosovës dhe njëkohësisht është çështje e zbatimit të ligjshmërisë dhe mbetje të kriminalitetit ekonomik, e cila bëhet në pjesën veriore të Kosovës.

Çështje tjetër, ishte çështja e hapjes së zyrave ndërlidhëse në mes Kosovës dhe Serbisë, mirëpo prapëseprapë e gjithë esenca e hapjes së zyrave ndërlidhëse mes Kosovës dhe Serbisë, siç tha kryeministri do të bëhet apo do të vendoset në zyrat e BE-së në Beograd dhe zyrat e BE-së në Prishtinë.

Çështje tjetër e cila aludon edhe ndoshta në një kohë tjetër, çështja e vendosjes së ambasadorëve në nivel të ambasadave. Kjo tregon se Kosova dita ditës, de fakto dhe de jure do të njihet nga Serbia, vetëm është moment kohe mbas zbatimit të marrëveshjeve.

Si çështje e tretë, mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe fetare, kryeministri tregoi se në bazë edhe të Pakos së presidentit Ahtisari ne kemi ligje të cilat garantojnë mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, si te serbët dhe shqiptarët dhe besoj se Policia e Kosovës është polici multi-etnike, se kemi në radhët e tyre edhe policë nga shqiptarët, serbët turqit dhe të gjitha minoritetet në Kosovë.

Çështje shumë e ndjeshme, çështja e transparencës së financimit të serbëve që jetojnë në Kosovë. Do të ishte ndoshta e rrugës dhe praktikë më e mirë, që t'i bëhet me dije

Brukselit, se njëherë e përgjithmonë strukturat ilegale serbe duhet të shuhën. Dhe, shteti serb, në rast se do që të dijë se ekziston shteti i Kosovës dhe dëshiron t'u ndihmojë serbëve në Kosovë, atëherë është Buxheti i Kosovës, si pikë në të cilën mund të ndahen këto fonde, mirëpo, t'ju tregohet destinomi i tyre i qartë.

Besoj që pas themelimit, siç prezantoi kryeministri, të fondit të veçantë së bashku me bashkësinë ndërkombëtare, të dihet nga do të shkojnë këto destinime dhe shthurja e strukturave ilegale serbe, që do të ishte gjëja më e mirë edhe për vetë Serbinë, e cila tash për momentin po përballet edhe me një krizë të madhe ekonomike dhe një krizë të madhe, e cila do të jetë edhe politike për të.

Çështja e pestë, në bazë të raportimit të kryeministrit është çështja e personave të zhdukur, ku do të ishte çështje më humanitare në mes dy shteteve, që të gjenden eshtrat e këtyre personave dhe familjarët e tyre të dinë ku është fati i tyre.

Në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është mjaftë e qartë se Kosova ka një sistem doganor, një sistem të drejtësisë dhe një sistem zinxhiror të Policisë dhe besojmë dhe shpresojmë që BE-ja të jetë konstruktive karshi Kosovës, se u pa mbrëmë deklarimi i saj. Ndërsa, për Serbinë s'ka mundur të presë diçka më tepër se sa fjalë, ndërsa veprimi i tyre do të shihet në të ardhmen. Dhe, Kosova të ketë lehtësira në procesin e integritetit evropian. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar SLS, zoti Miletic e ka fjalën.

PETAR MILETIĆ: Hvala gospodine potpredsedničke Skupštine.

U ime Poslaničke Grupe Samostalne Liberalne Stranke želim da kažem da premijeri Tači i Dačić imaju potpunu podršku za ono što rade u Briselu i da želim da im čestitam na političkoj hrabrosti i odvažnosti, što su preuzeli odgovornost za ove veoma osetljive teme, kojima se oni bave poslednjih meseci.

Takođe, želim da se zahvalim u ime poslaničke grupe i Evropskoj Uniji, posebno baronici Ešton, što posreduje u ovom dialogu, jer to garantuje da ono što bude dogovoreno biće i implementirano, baš onako kao što je i dogovoreno u Briselu.

Integrisano upravljanje carnima bi trebalo da doprinese lakšoj komunikaciji svih građana i boljoj slobodi kretanja, a ja mislim da je to jedan od ključnih interesa svih danas na Kosovu.

Prelazi još uvek nisu potpuno funkcionalni i bilo bi uzorno očekivati da to tako brzo bude gotovo, međutim čini mi se da je tu više u pitanju građevinski radovi, nego što je politička volja u pitanju. Obzirom da sam juče bio na jednom od prelaza, još uvek mi se čini da se oni koji tamo rade, ne snalaze baš najbolje, ali ja verujem da će to biti vrlo brzo rešeno, a ono što ostaje kao problem jeste naplata osiguranja na tim prelazima.

Dakle, to još uvek ostaje kao izazov i ja se nadam da će u nekom budućem periodu, premijeri naći načina ili oni koji budu se bavili ovim pitanjem da finansijske prepreke,

koje sada postoje na tim prelazima, budu uklonjene jer je danas preskupo ljudima da se kreću preko ovih prelaza i ja se nadam da će to biti vrlo brzo rešeno.

Što se tiče oficira za vezu, koji će biti postavljeni u Beogradu i Prištini, svakako da će oni poboljšati relaksaciju odnosa između Beograda i Prištine ali se takođe nadam da će oni otvoriti taj novi kanal komunikacije i da će to posebno doprineti normalizaciji odnosa između Beograda i Prištine.

Transparentnost u finansiranju institucija na Kosovu je od interesa i za Beograd i za Prištinu. Za Prištinu zato što će se tačno znati koje će institucije biti financirane a za Beograd će to biti značajno iz razloga, jer će se smanjiti zloupotrebe novca poreskih obveznika u Srbiji, tako da i tu vidim samo benefit od novog dogovora.

Vi znate da je za nas kosovske Srbe od izuzetnog značaja da manastiri i crkve Srpske Pravoslavne Crkve budu zaštićeni i zato pozdravljamo i dogovor oko formiranja nove jedinice Policije Kosova, koja će se baviti zaštitom ovih manastira, kako bi pravo na veroispovest i na slobodu religije bila zagarantovana.

Oko nestalih i kidnapovanih lica, ja zaista ne mislim da treba puno trošiti reči, jer je to duboko humano pitanje i mislim da ona ni u kom slučaju ne sme da zavisi od političke volje bilo koga, već da se ni Beograd, ni Priština, ni Međunarodna Zajednica ne smeju smiriti, dok ni poslednja sudbina bilo kog nestalog i ubijenog u toku i nakon '99-te ne budu rasvetljene.

I na kraju, želim da kažem da će implementacija ovih dogovora koje su se dogovorili premijeri u Briselu, otvoriti mogućnost da se postignu neki novi dogovori, jer imamo još puno nerešenih pitanja. Dakle, moći će da se nastavi sa pričom i o telekomunikacijama i o energetici i o mnogim drugim otvorenim pitanjima, koje i Kosovo i Srbija imaju.

Još jednom, želim da se zahvalim predsedniku Vlade Kosova na ovom izveštaju!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Emin Gërbeshi e ka fjalën.

EMIN GËRBESHI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Ne sot po flasim për menaxhimin e integruar të kufijve, pa e vendosur pushtetin në një pjesë delikate të shtetit tonë.

Gjithashtu, po flasim për këtë menaxhim dhe për arritjen e një marrëveshjeje me Republikën e Serbisë, pa e pasur tekstin e marrëveshjes dhe pa e ditur saktësisht, se çka parasheh kjo marrëveshje.

Mendoj se kjo marrëveshje do të duhej të paraprinte në vendosjen e rendit dhe ligjit në pjesën veriore të Kosovës dhe me zhbllokimin e rrugëve dhe qarkullimin e lirë të njerëzve dhe mallrave. Dhe, po të ndodhte kjo, atëherë do të kishte kuptim të plotë edhe kjo marrëveshje.

Në parim, për çfarë marrëveshje po flasim, kur Policinë dhe doganierët ne jemi detyruar t'i bartim deri në kufi me helikopter dhe s'mund t'i çojmë atje, përmes rrugës tokësore.

Tepër diskutabile është edhe çështja e lehtësimeve doganore për serbët e veriut, që lejon vazhdimin e gjendjes së tanishme, lejon kontrabandën, lejon krimin e organizuar dhe se dalëngadalë, këtë pjesë të territorit e çon drejt një statusi special.

Kjo marrëveshje nuk është tërësisht siç po paraqitet, në favorin e Kosovës. Dhe, unë mendoj se do të prodhojë pasoja shumë të rënda politike dhe këto pasoja do të jetë vështirë të riparohen më vonë. Prandaj, i sugjeroj kryeministrit të Kosovës dhe të gjithë aktorëve, që janë në bisedime, që të kenë kujdes, sepse pranimi i marrëveshjeve, të cilat janë gjithsesi diskutabile, për neve do të jenë të kushtueshme më vonë.

Koha ka dëshmuar, se gjithherë e sa herë kemi qenë të papërgatitur dhe kemi hyrë ashtu pa u përgatitur si duhet në bisedime, jo gjithherë kemi vendosur në favor të shtetit tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Lladrovci.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, nënkryetar!

E nderuara zëvendëskryeministre,

Ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Bisedimet që po zhvillohen në Bruksel, të ndërmjetësuara nga Bashkimi Evropian, midis Kosovës dhe Serbisë, kanë për synim avancimin e bashkëpunimit rajonal, lirisë së lëvizjes dhe sundimit të ligjit.

Në këtë kuadër, gjashtë marrëveshjet e arritura deri më tani dhe fillimi i zbatimit të marrëveshjes mbi menaxhimin e integruar të kufirit, janë në interes të Kosovës, si në planin e brendshëm ashtu edhe në planin ndërkombëtar.

Ky dialog duhet të vazhdojë për hir të normalizimit të marrëdhënieve, në frymën e synimeve të Kosovës për integritet evropian. Paraprakisht, kësaj, Kosova duhet të dalë me strategji gjithëpërfshirëse për veriun, në fokus të veçantë integrimin e serbëve të veriut. Ky plan do të kërkonte largimin e shpejtë të strukturave paralele, duke kërkuar nga BE të vendosin presionin shtesë mbi Serbinë, për të hequr strukturat e tyre paralele në veri.

Në këtë kuadër, Kosova duhet t'i marrë shumë seriozisht rekomandimet e Bashkimit Evropian për të zhvilluar një agjendë gjithëpërfshirëse për veriun dhe duhet menjëherë të angazhohet për zgjerimin dhe zhvillimin e mekanizmave financiar komunikues dhe politik në veri.

Kryeministri dhe Qeveria e Kosovës kanë shfaqur vendosmërinë, për të zhvilluar negociatat me Serbinë, në funksion të mbrojtjes dhe avancimit të interesave të Kosovës dhe gjithnjë duke qenë maksimalisht transparentë dhe në institucionin e Parlamentit dhe

qytetarët e Kosovës. Ky raportim i kryeministrit sot, është dëshmia më e mirë e këtij përcaktimi.

Vendosmëria e Qeverisë në procesin e dialogut me Serbinë, duhet përkrahur dhe këtij procesi do t'i ndihmonte shumë ekzistenca permanente e përkrahjes së nevojshme politike.

Të nderuar deputetë, në këtë kuadër dua të përshëndes edhe gatishmërinë e dëshmuar për Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës. Kyçja e këtij subjekti politik me zotin Blerim Shala si koordinator, tregon peshën që ndjen kjo parti dhe përgjegjësinë e saj ndaj zhvillimeve të rëndësishme, siç është procesi i bisedimeve të tashme.

Pra, AAK zgjodhi të jetë protagoniste dhe jo spektatore e këtij procesi, që ka të bëjë edhe me fatin e vendit tonë. Uroj që edhe në zhvillimet tjera jetike për vendin të jemi të bashkuar, sepse vetëm bashkimi dhe mirëkuptimi është garancia e suksesit dhe të së ardhmes më të sigurt për Kosovën dhe qytetarët tanë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Zoti kryesues i seancës,
Zotërinj ministra që jeni këtu,
Zonja e zonjusha deputete dhe zotërinj deputetë kolegë,
Kjo është hera e tretë që kryeministri i Kosovës informon Kuvendin për ndodhitë në bisedimet e tij me homologun e tij serb, nën mbikëqyrjen ose drejtimin, si të doni, të baroneshës Eshton.

Unë mendoj që kjo është mirë, në kuptimin e ritualit të pranuar nga ai dhe në pajtim me një pikë të rezolutës, të cilën e ka aprovuar ky Kuvend, lidhur me këto bisedime.

Pa marrë parasysh, që do të duhej të ishte ky informim në nivel të raportimit, që i bie, të kishte më shumë evidenca, më shumë të dhëna dhe jo vetëm paraqitje të vijave të trasha politike të komunikimit.

Po edhe ato që dimë për ndodhitë, edhe ato që mësojmë në bankat e Kuvendit nga informatat që na jep kryeministri, ne menjëherë na kujtohet çfarë ka kjo rezolutë tjetër, brenda saj. Kjo rezolutë tjetër, brenda saj, e cila me substancën e vet e vë në lojë, në përgjegjësi të plotë Kuvendin rreth këtyre bisedimeve thotë, që secila marrëveshje që është ndërkombëtare, e që i bie që të gjitha këto marrëveshje janë ndërkombëtare, se janë po themi ndërmjet dy shteteve sovraane dhe të pavarura kalon nëpër Kuvend, bëhet e plotfuqishme, e zbatueshme nëse votohet me 2/3. Unë tash menjëherë i lidh këto, po mirë ky menaxhimi i integruar i kufijve a është marrëveshje ndërkombëtare, apo lokale. Ç'është kjo? Ne po themi dhe kryeministri po thotë në interpretimin e vet që është marrëveshje ndërkombëtare. Atëherë, kjo marrëveshje duhet të votohet për t'u bërë e plotfuqishme, e realizueshme, e pranueshme me 2/3 e këtij Parlamenti, gjithnjë duke e zbatuar njërën prej pikave të rezolutës që e ka bërë ky Parlament për këto bisedime.

Shkojmë tutje. Është në ndërtim e sipër përfaqësimi i dy vendeve respektive në Beograd dhe në Prishtinë, të cilat në gjuhën popullore, dikush për qejfi i quan ambasada, dikush i quan zyra lidhjeje. Nuk është me rëndësi, janë zyra përfaqësuese të të dyja vendeve, zyra përfaqësuese institucionale dhe politike. Atëherë, a duhet, a janë edhe këto marrëveshje ndërkombëtare, a duhet të kalojnë me 2/3 në Parlament, në mënyrë që pastaj ta kenë fuqinë e plotë legale të përfaqësimit, të jenë legjitime dhe të jenë bërthama e asaj që ne sot mund ta quajmë, jo vetëm përfaqësim ndërlidhës, por përfaqësim i vërtetë diplomatik.

Pse po insistoj? Sepse duhet të jemi insistues konkret substantial karshi dokumenteve dhe politikave të rëndësishme të vendit tonë, karshi të gjithëve, edhe Serbisë. Sepse atëherë ne do të kemi bisedime që do të shkojnë deri në pafundësi, si krijimi i fakteve të kryera që quhen fetakompli, që janë pjesë të vogla, të cilat dikur mund ta ndërtojnë një mozaik të të gjitha ndodhive, por kurrë nuk e ke të qartë a do të jetë ai mozaik mirë i lidhur, a do të jetë një tërësi stof copë, apo do të jetë një mozaik, që me gjuhën e stofit, i bie me arna. Këtu merr përgjegjësi edhe ky Kuvend që tash, sepse jemi në fillim të bisedimeve. Merr përgjegjësi edhe Qeveria dhe konkretisht kryeministri, që është personaliteti numër një për Kosovën që i zhvillon këto bisedime.

Nga ato që u dëgjuan sot këtu, unë dëgjova për një fond të veçantë, edhe për mbrojtje të veçantë, thuhet të monumenteve kulturore e fetare. Unë për vete, po flas në njëjës, në emër dhe mbiemër si përfaqësues, mendoj që është gabim të krijohet fond i veçantë. S'ka kurrfarë nevojë të krijohet fond i veçantë për veri, nëse tri komuna ose tri e gjysmë, a dy e gjysmë, sepse do të krijojmë diferencime brenda qytetarëve të Kosovës pikërisht të atij nacionaliteti që... Mund të ketë në fondin unik të Kosovës alokime të të hollave të veçanta në pjesën e fondeve për zhvillim. Dhe, kjo është krejt natyrë tjetër, është natyrë tjetër kushtetuese dhe zhvillimore, dhe e zhvillimeve të brendshme, kur krijoni fond me destinim të veçantë, dhe meqë thuhet aty do të jenë aty bashkësia ndërkombëtare, Serbia dhe Kosova. Unë po flas për interpretimin, s'po flas për letra, se letra nuk kemi.

E njëjta gjë është puna, që është bërë mit, puna e rojës. Kemi diskutuar me vite të tëra qysh ruhen monumentet. Jo në Kosovë kurrë s'besoj, as nuk jam i bindur që ka nevojë që në vitin 2012 duhet të ndërtohen forca speciale për t'i mbrojtur, po i bie kishat, se unë nuk po dëgjoj se po përmenden edhe xhamitë, që ka nevojë të bëhen njësi speciale për t'i mbrojtur këto, se nuk i sulmon askush. Dhe, fundi i fundit, po të sulmohen, ato nuk mund të mbrohen këto me milici speciale. Shans nuk ka. Pra, ne po krijojmë paragjykim për një ndodhi që nuk ndodh. Mund t'i ketë nën kujdes, ku ka nevojë, policia normale si kudo, e jo policia speciale.

Edhe e treta, po i përmendin strukturat paralele të sigurisë në veri. Jo zotëri! Duhet të ketë shprishje, mospranim jo vetëm strukturave të sigurisë së Serbisë, por të strukturave jolegitime, jolegale, pushtetore, se në veri nuk veprojnë veç keqbërësit dhe dallaverxhinjtë e kriminelët, por ne e kemi një shtresim pushtetar që thotë “unë legalisht sundoj këtu”.

Dhe, në fund, i kam dy pyetje: Mirë, po fillon qarkullimi. Me çfarë dokumentesh qytetari i Republikës së Kosovës (shqiptar) e kalon në kufirin Kosovë-Serbi dhe përtej Serbisë

dhe me çfarë dokumentesh qytetari, përsëri i Republikës së Kosovës (serb) qarkullon në këto pika në Kosovë, përtej Kosovës dhe në Serbi, dhe përtej Serbisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Thaçi e ka fjalën, për sqarim shtesë.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuari nënkryetar Haliti!

I nderuari tjetër nënkryetar parafolës, zoti Hamiti,

IBM-j, ju e dini se është menaxhimi i integruar i kufirit, e jo ndryshim i kufirit. Do të thotë, duhet bërë ky dallim. Parlamenti nuk ka marrë ndonjë vendim as sa i përket menaxhimit të integruar të kufirit me Maqedoninë, me Shqipërinë, e as me Malin e Zi, prandaj do të zbatohet praktika e tillë, e ne jemi duke e respektuar gjithmonë Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës, kriteret dhe standardet evropiane

Ndërsa sa i përket njësisë së veçantë multietnike të Policisë, unë dëshiroj vetëm të sqaroj se nuk është njësi speciale, është njësi e veçantë e Policisë së Kosovës, që përbëhet prej shqiptarëve, prej serbëve, boshnjakëve, turqve dhe të tjerëve dhe domosdoshmërinë që në këtë njësi të jetë dikush që mund të flasë dhe të komunikojë edhe në gjuhën serbe. Kemi lokalitete të caktuara ku jetojnë me shumicë shqiptarët, dhe ndonjëherë te ndonjë monument kulturo-historik, apo diçka tjetër, nuk ka përfaqësues të komunitetit serb dhe ka ankesa të ndryshme. Prandaj, që të jemi sa më praktik, jemi pajtuar që në kuadër të këtyre njësive të jetë, ta zëmë, nëse janë 3, të jenë një ose dy serbë, një i komuniteti boshnjak apo turk. Kështu që nuk besoj që rrezikohet funksionaliteti i shtetit të Kosovës me bërjen multietnike të këtyre njësive të Policisë së Kosovës.

Sa i përket fondit të veçantë, unë dëshiroj të theksoj se ky fond nuk është diçka e jashtëzakonshme. Përbëhet prej donatorëve ndërkombëtarë, Qeverisë së Kosovës, bashkësisë ndërkombëtare, por edhe nga vullneti, nëse Qeveria e Serbisë dëshiron t'i ndihmojë komunat me shumicë serbe, dhe kjo është e përfshirë edhe në dokumentin e presidentit Ahtisari. Prandaj, gjithçka është në kornizat e këtij dokumenti.

Ndërsa udhëtarët do të udhëtojnë me dokumentet përkatëse të shteteve përkatëse. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hamiti e ka kërkuar fjalën për replikë.

SABRI HAMITI: Nuk fola për ndryshim kufijsh, por për kufij, se krejt loja, për të mos thënë krejt fuqia jonë e ndërtimit të këtij vendi është për t'i krijuar ata kufij, dhe unë thashë të jenë kufij, e jo për t'i ndryshuar. Po, përkrahja, pranimi i kufijve ndërkombëtarë është çështje ndërkombëtare. Ja, ku e keni ministrin e Drejtësisë që i njeh këto punë dhe e di që është kështu, pak a shumë.

E dyta, nuk është problemi nëse e quajmë ne njësi speciale a të veçantë, se në esencë funksionalisht është e njëjta gjë. Edhe fondi i veçantë nuk është asgjë e re! Që kur është i veçantë, është i veçantë, është përjashtues, në një mënyrë, për një element, dhe s'ke si e quan ndryshe.

Unë edhe një herë po insistoј që asgjë nuk pengon që Kosova të bëjë financime të sforcuara në një terren të veçantë të Kosovës, nesër në përdim e në jug e në qendër, ku ka nevojë, prej një fondi të veçantë, në mënyrë që të mos krijohen fonde të tilla. Sa për ato dy pyetjet e fundit, unë nuk mora përgjigje. Unë e pres që ministri i Mbrojtjes ndoshta i jep këto përgjigje.

Puna tjetër, që desha ta vazhdoј, është puna e raportit me BE-në. Është e vërtetë që ne kemi kufij edhe me të tjerët, po zotëri kryeministër është raport krejt tjetër me Serbinë dhe ju e dini, edhe unë e di, dhe të gjithë e dinë, nuk është situata homologe me Shqipërinë, me Maqedoninë, me Malin e Zi. Nën një, ne nuk kemi kurrfarë problemesh politike, nën dy - ata na kanë pranuar, ata e pranojnë Kosovën shtet të pavarur. Ne kemi të bëjmë me një fqinj, i cili është në konflikt...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Hamiti! Edhe kundër-replikë keni të drejtë. Kryeministri Thaçi e ka fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Nuk është replikë, por më tepër plotësim e sqarim për zotin Hamiti.

Përsëri po them, sa i përket njohjes së kufijve ndërshtetërorë apo ndryshimit, këto gjëra ratifikohen në Parlament. Ndërsa ky është një proces...

(Ndërhyrje)

...plotësisht po pajtohesh me mua, prandaj faleminderit shumë! Por, në të njëjtën kohë, ne tash kemi të bëjmë me një proces të menaxhimit të integruar të kufijve të Republikës së Kosovës në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve të Kosovës, në bazë të dokumentit të presidentit Ahtisari, në bazë të të cilit e kemi shpallur Kosovën e pavarur dhe sovranë, nënshkruar i së cilës jeni edhe ju personalisht, me meritën tuaj, natyrisht dhe legjitimitetin qytetar.

Sa i përket fondit të veçantë, kjo është e përcaktuar me dokumentin e Ahtisarit, të cilin e keni pranuar si Kuvend i Kosovës dhe unë do ta respektoj në përpikëri këtë dokument. Edhe sa i përket njësive të veçanta të Policisë, e qartësua shumë qartë - është çështje e një polici më tepër, e dy policëve më tepër, sepse ta zëmë nëse në Deviç, te Kisha Serbe, ku nuk jetojnë serbët, dhe është problem ta zëmë të dërgojmë njësi me policisë vetëm shqiptarë për komunikim me personelin përkatës të kishës, e nuk e dëmton shtetin e Kosovës dërgimi i një polici më tepër që komunikon në gjuhën serbe.

(Ndërhyrje)

Po s'po i dërgojmë krejt serbë, por duhet të jemi realistë dhe tash dokumentet që i keni pranuar ju mos kërkonin të ridiskutohen përsëri se nuk është ndonjë kampanjë elektorale, por të jemi të sinqertë me njëri-tjetrin. Gjithçka është e përcaktuar dhe respektohet në

përpikëri Kushtetuta e ligjet e Kosovës. E kam theksuar edhe më herët, edhe ndokush tjetër po të dojë ta shkelë Kushtetutën, nuk e lejoj këtë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja zëvendëskryeministre Tahiri, e ka fjalën.

(Ndërhyrje)

Dy fjalë, e dobishme, po rregulla është rregull, zoti Hamiti. Një minutë zotit Hamiti, në kundërshtim me rregulloren.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Zoti kryeministër,

Unë edhe një herë po e përsëris, të gjithë këto që po bëhen fakte të kryera, rezoluta jonë na obligon të jenë tekste të shkruara dhe të kalojnë me 2/3 në Parlament. Të mira a të këqija, vendos Parlamenti, sepse kështu kemi vendosur.

Dhe e dyta, raporti me BE-në. Unë pajtohem me zotin Bajrami që thotë që duhet të propozohen dhe pikat kryesore të diskutimeve nga Kosova, që i bie nga ju, në tavolinën ku shkoni.

Dhe tjetra, të kërkohet më me ngulm nga BE-ja çfarë po jep ajo, sepse ai tajmin që ka ndodhur me 10-shin të bisedohet për shanset e Kosovës dhe të Serbisë dhe me 10-shin të çelen ato dyer në dy pika kufitare, po shihet që është një kohë e konstruktuar. Pra, çka tutje, që i bie zoti kryeministër, as s'dua të bëjë propagandë, mos bëj as ti, sepse po bisedojmë për interesat e një vendi, që s'kanë të bëjnë veç me ju si kryeministër, por me një vend, por si do që të jetë, këtu duhet të sqarohen çështjet, sepse janë obligime të mëdha. Çka do të...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Zoti Thaçi e ka fjalën prapë, për sqarim shtesë.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuari zoti Hamiti,

Po jua përmendi edhe emrin, i nderuari deputet zoti Sabri Hamiti.

Për të jua dhënë mundësinë për komunikim dhe sqarim, sepse është edhe në interes të opinionit publik, nëse nuk është në kundërshtim me Rregulloren e Kuvendit, dhe kryesuesi me siguri i njeh dhe i lexon më mirë. Por, cili është synimi ynë? Synimi ynë, ju e dini, është konsolidimi dhe forcimi i shtetit të Kosovës dhe ky proces të përmbillet me njohjet reciproke ndërmjet shtetit të Kosovës dhe Serbisë.

Unë e kuptoj se shumë më lehtë është të shtrohen çështje kritike, që ndonjëherë janë edhe me interes për opinionin publik, por dhe për politikën tonë kosovare, por më vështirë është të merren përgjegjësitë. Ajo çka është jashtëzakonisht me rëndësi, është se e keni përkrahur këtë proces të dialogut, që është në interesin e normalizimit të marrëdhënieve ndërshtetërore ndërmjet shtetit të Kosovës dhe Serbisë. Ndërsa ajo çka ne duhet të kërkojmë nga Bashkimi Evropian, Kosova nuk besoj që e ka atë fuqi, edhe ju e dini, që ta

përcaktojë agjendën e Bashkimit Evropian, por duhet të them që ne duhet të jemi të singertë me njëri-tjetrin. Ju e dini se Kosovën e kanë njohur 22 vende të Bashkimit Evropian, 5 vende ende nuk e kanë njohur dhe prandaj Kosovës po i vonohet perspektiva evropiane për shkak të mosmarrëveshjeve politike në Bruksel. Dhe, ky është zhgënjim juaji, imi, i të gjithë deputetëve të Kosovës, i të gjitha institucioneve të vendit, i gjithë qytetarëve të vendit. Dhe, kjo është e vërteta.

Prandaj, unë nuk mund ta përcaktoj agjendën e njohjes me datë për Spanjën, as për Rumaninë, as për Greqinë, as për Sllovakinë, e as për Qipron. Kush e ka atë fuqi, urdhëroni! Por, besoj që bashkërisht do t'ia dalim që t'i bindim së paku në mënyrë unike ta përkrahin perspektivën evropiane të Kosovës. Faleminderit!

(Ndërhyrje)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Bajrami, replikë.

ARSIM BAJRAMI: Nuk është replikë, por më tepër me emocionin e replikës po e marrë fjalën, por po dua ta sqaroj një moment që e shtroi profesor Hamiti. Dhe atë moment ndoshta duhet të na e sqarojë edhe Qeveria, sepse është krijuar një farë iluzioni se çfarëdo marrëveshje që arrihet, çfarëdo hapi, duhet të vijë në Parlament edhe të ratifikohet.

Në fakt, menaxhimi i integruar të kufijve nuk ka ndërruar asgjë, vetëm që e ka identifikuar kufirin aktual që e ka Kosova dhe e ka ndërruar metodën se si kontrollohet. Pra, ka bërë menaxhimin e integruar të kufirit, që nuk kërkon marrëveshje, sepse të gjitha shtetet e aspirojnë një gjë të tillë.

Unë kur e kam lexuar rezolutën, e kam kuptuar në atë mënyrë që nuk do të ketë dhjetëra marrëveshje të vijnë për ratifikim në Kuvend. Por, do të ketë një marrëveshje të vetme, me të cilën përmbyllet procesi dhe shënohet normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë. Besoj që në atë marrëveshje finale, që do të nënshkruhet, dhe ku në fakt përmbyllet procesi i normalizimit, mendoj se do të futen të gjitha elementet, apo të gjitha rezultatet e arritura në këtë proces të negociatave, por ajo që deri tash është arritur është absolutisht në pajtim me Kushtetutën e Kosovës, dhe është në fakt implementim i Kushtetutës së Kosovës.

Unë pres që në fund të procesit duhet të diskutohet shumë se cila do të jetë forma e përmbylljes së procesit. Ne e kemi pasur edhe propozimin e zëvendëskryeministrit Kuçi për një traktat paqeje. Të shohim cila do të jetë forma juridike, modalitetet juridike, me të cilën ajo ngrihet në nivel të një marrëveshjeje ndërkombëtare, të garantuar edhe nga Bashkimi Evropian dhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me të cilën përmbyllet ky proces. Pra, është herët të pritët tash për çdo përparim të procesit të normalizimit, të pritët për çdo akt marrëveshjeje konkrete, por unë supozoj se të gjitha këto të tërat do ta bëjnë një marrëveshje finale...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Tahiri.

ZËVENDËSKRYEMINISTRJA EDITA TAHIRI: I nderuar kryesues,

Deputetë të nderuar,

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Unë desha të ndërlidhem me pyetjet e deputetit Hamiti lidhur me miratimin e marrëveshjes së IBM-së në Kuvend dhe të jap këtë përgjigje.

Sipas ligjeve të Republikës së Kosovës, marrëveshja e IBM-së është një marrëveshje teknike dhe ligjet tona e thonë që Qeveria është bartëse e procesit dhe Ministria e Brendshme është zbatuese, jo vetëm në raport me shtetin fqinj, Serbinë, por edhe me shtetet tjera, me të cilat jemi duke i arritur këto marrëveshje.

Prandaj, Qeveria e Republikës së Kosovës e ka miratuar marrëveshjen e IBM-së, të arritur vjet në Bruksel, në dhjetor të vitit 2011, dhe ministri i Punëve të Brendshme, zoti Bajram Rexhepi, e ka nënshkruar protokollin teknik për anën tonë, si dhe homologu i tij në Serbi.

Prandaj, si marrëveshje teknike, me ligjet e Kosovës për IBM-në, marrëveshjet miratohen në Qeveri dhe ne e kemi bërë këtë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hamiti, paraqitu se unë s'po ta marrë fjalën. Paraqitu për replikë!

SABRI HAMITI: Unë po paraqitem me këtë sustën juaj teknike.

Po, mirë, zonja Tahiri thotë që nuk është kjo marrëveshje ndërkombëtare, sepse e ka miratuar Qeveria. Unë besoj që është, se atëherë pse e ka miratuar Qeveria dhe problemi, zonja zëvendëskryeministre, nuk është krejt i thjeshtë. Ju e dini fort mirë, sepse i keni dy mënyra të interpretimit dhe dy mënyra të përkthimit të atij teksti, meqë njëra i quan pika kalimtare, tjetra kufitare. Ana tjetër e bisedimeve për çdo ditë e thotë që janë pika kaluese, kontrolluese, e jo janë pika kufitare. Prandaj, unë i grah logjikës sime pse duhet të shtrohet këtu. Edhe në Evropë, edhe këtu, dhe me bashkëbiseduesit. Ju po thoni që është në rregull, le të jetë në rregull. Do ta provojmë. Edhe një herë, për tipat e dokumenteve të qarkullimit ende s'po më përgjigjet askush. Unë e bëra një pyetje. Është mirë ta thoni edhe atë.

KRYESUESI: Kundër-replikë, zonja Tahiri.

ZËVENDËSKRYEMINISTRJA EDITA TAHIRI: Deputet Hamiti,

Proceset dhe zbatimet bëhen me ligjet e shtetit, jo me logjikën e individëve. Ju lutem, lexojeni Ligjin e Republikës së Kosovës për IBM-në dhe do ta shihni se marrëveshjet e IBM-së të shtetit tonë me shtetet fqinje i miraton Qeveria, i zbaton Ministria e Punëve të Brendshme, si përgjegjëse për zbatimin e IBM-së.

E dyta, sa u takon dokumenteve, ju e dini që marrëveshja për lëvizjen e lirë, e arritur ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë e ka miratuar parimin e kalimit me leje të njoftimit, pra me dokumentet zyrtare të Republikës së Kosovës për ata që udhëtojnë në Serbi. Për ata që e përdorin Serbinë si territor transit, atëherë ata me vete duhet t'i kenë edhe lejet e njoftimit, edhe pasaportat e Republikës së Kosovës, sepse në ndalje duhet të...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Nuk ka si të mos na kujtohet premtimi i kryeministrit që në këtë proces negocues, çështja e të pagjeturve do të jetë prioritet. Ai ka thënë që do të kthehen të gjithë trupat e shqiptarëve të vrarë e rrëmbyer nga Serbia gjatë luftës së fundit, por çështja e të pagjeturve as që u zu në gojë. Pra, kryeministri edhe një herë i mashtroi familjarët e të pagjeturve.

Në shtator të vitit 2008, Lëvizja “Vetëvendosje” pati propozuar 13 pika për ta bërë Kosovën shtet sovran e me integritet territorial, e ndër të tjera ka qenë edhe vënia në shënjestër e burimeve financiare të strukturave ilegale dhe armiqësore të Serbisë dhe prerja e financimit të tyre nga Serbia dhe nga krimi i organizuar e bizneset informale.

Shpërbërja e strukturave paralele është çështje që nuk duhet të vihet në diskutim. Nuk shpërbëhen strukturat paralele në negociata me Serbinë, e aq më pak kur pranohen ato, e kërkohet vetëm transparenca në financimin e tyre. Tash, përveç lejimit të këtyre strukturave që të veprojnë të papenguara në Kosovë, Thaçi ka pranuar edhe që t'ua sigurojë atyre një pjesë të financimit nga TVSH, që i paguhet Buxhetit të Kosovës.

Nuk ka si të mos na kujtohet përpjekja e Thaçit që ta bindë opinionin se strukturat ilegale e kriminale të Serbisë, të cilat veprojnë të papenguara në Kosovë, do të shpërbëhen tërësisht. Gjersa tani, ju po i akomodoni ato me veprimet tuaja të pamatura dhe të dëmshme, pasi jeni pajtuar që të ketë rritje të transparencës të qarkullimit të parasë, që vjen nga Serbia në Kosovë.

Pra, para këto që vine për strukturat ilegale. Thuajse paska qenë problemi vetëm te transparenca. Por, bërja publike e parave nuk nënkupton edhe zhbërjen e strukturave paralele, sepse problemi qëndron te prania e tyre në Kosovë dhe cenimi i vazhdueshëm i sovranitetit dhe integritetit, cenimit të jetës dhe sigurisë së qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Por, çka nënkupton kryeministri me transparencë për strukturat ilegale e kriminale serbe? A dëshiron të dijë ai se sa e ka pagën Marko Jakshiqi? Sa kushtoi operacioni logjistik për djegien e pikave kufitare? Sa u pagua snajperisti që e vrau Enver Zymberin? Sa kushtoi sulmi terrorist i strukturave ilegale e armiqësore të Serbisë kundër familjes së Selver

Haradinajt? Sa kushtuan vrasjet e 11 mijë shqiptarëve dhe dëbimi i 11 364 qytetarëve nga veriu i Kosovës?

Njohja e këtyre fakteve nëpërmjet transparencës së financimit të strukturave ilegale e kriminale të Serbisë në Kosovë nënkupton njohjen e këtyre strukturave nga kjo Qeveri, pra njohjen e strukturave që nuk e njohin shtetin e Kosovës, e për më tepër e luftojnë atë me çdo mundësi, çdo ditë e çdo natë. Ashtu e mbron interesin e vendit, kryeministri? Apo e kanë shantazhuar që tani edhe të fillojë ta njohë edhe praninë e Serbisë në Kosovë dhe ta trajtojë atë si normale. Një kryeministër i mirëfilltë do të punonte me hapa konkretë drejt zhbërjes së këtyre strukturave dhe shtrirjes së sovranitetit në gjithë territorin e vendit.

Pajtueshmëria e kryeministrit me Daçiçin është kundërkushtetuese, pasi Kosova në Kushtetutën e saj thotë: “Kosova është sistem unik doganor”, e po ashtu, “Kosova është një zonë unike fiskale”.

Fakti që Qeveria po e vendos që një pjesë e territorit tonë, pra pjesën veriore, të funksionojë si zonë e pavarur financiare, domethënë që kryeministri ka shkuar shumë larg Kushtetutës. Kurse është kjo Qeveri që vazhdimisht thirret në Kushtetutë.

Marrëveshja për IBM-në gjithashtu është në kundërshtim me vetë rezolutën nga PDK-ja, AAK-ja, të cilën e përkrahu edhe LDK. Derisa në rezolutë shkruan se nuk do të merret asnjë vendim që do ta prekë sovranitetin dhe territorin, në anën tjetër bëhet marrëveshje me Daçiçin që veriu të pavarësohet financiarisht nga Republika e Kosovës. Kjo nuk mund të konsiderohet ndryshe, veçse ndërhyrje në sovranitet.

Fakti që pikat doganore nuk do të përputhen me kufijtë tanë që i kemi me Serbinë, është zgjidhje e dëmshme dhe lajm i keq për Kosovën.

Nuk guxojmë të lejojmë që kufiri ynë doganor të zbresë në lumin Ibër. Ky do të ishte edhe pranim de facto i një kufiri që e ka vendosur me barrikada krimi i organizuar, në bashkëpunim me strukturat e paligjshme të Beogradit në veri.

Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje po krijohen 2 kategori të popullatës serbe në Kosovë dhe në përgjithësi. Po krijohen 2 lloj qytetarësh në Republikën tonë, ata që paguajnë taksa dhe ata që nuk paguajnë taksa. Sepse vetëm kështu do Serbia!

Kjo gjithashtu është antikushtetuese, sepse Kushtetuta thotë: “Të gjithë qytetarët janë të barabartë para ligjit dhe obligimeve që i kanë ndaj shtetit, por edhe të drejtat që shteti duhet t’ua garantojë atyre”.

Kjo marrëveshje mund të kualifikohet edhe si diskriminuese për një kategori të qytetarëve dhe favorizuese pa të drejtë për një grup tjetër të qytetarëve.

Një kritikë duhet t'i shkojë edhe opozitës, e cila ia dha dritën jeshile dhe mbështetjen e plotë kryeministrit që pa kurrfarë kushti të shkonte në Bruksel të takohet me Daçiqin dhe të na kthehet në Kosovë me këso lloj marrëveshjeje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Muhamet Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar kryesues i Kuvendit,
I nderuar kryeministër,
Të falënderohemi për informatat e rregullta që po i marrim nga fillimi i bisedimeve lidhur me përmbajtjen e tyre.

Mendoj se është mirë që i kemi këto informata, por nuk jam i sigurt se në këtë mënyrë mund tashohim tërësinë e problemeve, tërësinë e situatës lidhur me bisedimet.

Së pari, është mirë që e kemi një rezolutë, e cila megjithatë është shumë globale, që lë një hapësirë manovruese për ekipin tonë negociator që të gjenden zgjidhje të dypalëshe, por, në anën tjetër, mungesa e një platforme, e cila i cakton disa pika të rëndësishme, të cilat janë të interesit jetik për Kosovën, gjithashtu është një hendikep për mua. Është një hendikep, sepse po përballemi këtu me një lloj ambiguiteti edhe apo dykuptimësie të asaj që po ndodh dhe të asaj që po bisedohet.

Dhe, natyrisht që nëpërmjet ambiguitetit, secila palë përpiket ta qetësojë oborrin e vet, ta qetësojë shtëpinë e vet, por në anën tjetër, në situatën në të cilën gjendemi, ambiguiteti ndoshta na mundëson t'i mbajmë gjallë bisedimet, e të ecim përpara me interpretime të ndryshme të të njëjtit fakt, të dy palët e bisedimeve, por nuk e di sa do të jetë frytdhënës kjo.

Ambiguiteti i kombinuar me një pjesë të territorit, të cilin e kontrollon Serbia, për mua paraqet një rrezik potencial. Në qoftë se ne pajtohemi që ta kemi një menaxhim të integruar të kufirit dhe jemi pajtuar, atëherë puna e parë që do të duhet të bëhet është që kalimi të jetë i lirë deri te ai kufi dhe prej atij kufiri, e të mos kenë nevojë doganierët e Kosovës të shkojnë atje me helikopter.

Gjithashtu, problemi i sistemit unik financiar doganor, nuk kemi arsye të mos i besojmë sot kryeministrit, ai po thotë që nuk po rrezikohet, dhe unë besoj se nuk ka diçka të shkruar që të rrezikohet, por në qoftë se ne e krijojmë një situatë kur mallrat kalojnë, mallrat që do të ndalen për konsum në veri përkohësisht, e kalojnë kufirin dhe duhet të vijjnë për doganim në terminalin në Mitrovicë. Si do të mund të kontrollohet ky doganim, kur gjithë ata kamionë mund të ndalen atje në pjesën veriore, ku s'ka qasje policia jonë, s'ka qasje as KFOR-i, as EULEX-i. Si do të ruhet kjo?

Unë mendoj se këto çështje janë tejet delikate dhe ambiguiteti ose dykuptimësia rreth këtyre duhet të kontrollohet disi. Nuk e di se çfarë forme kanë këto bisedime, rezultatet e tyre, marrëveshjet. A janë dokumente të shkruara, a jeni dakord në biseda xhentëlmene, apo si do të jenë. Është mirë që ne informohemi, por unë e di që në rezolutë nuk është fjala për informim. Është fjala për raportim, domethënë raportim me shkrim, që ne ta

kuptojmë çfarë po ndodh, dhe të mund ta kontrollojmë diqysh rrjedhën e këtyre bisedimeve dhe t'i bëjmë ato më produktive. Natyrisht që këtu po merr përgjegjësi edhe Komisioni Evropian, Bashkësia Evropiane, që po i mbikëqyr këto bisedime. Është njëfarë garantimi, por për mua nuk është gjithçka shumë e qartë, nuk është shumë sistematike dhe ndoshta duhet të mendojmë që ta krijojmë një sistem pak më të qëndrueshëm, një qartësi më të madhe, një raportim, për të mos thënë ndoshta edhe një seriozitet më të madh të të gjitha palëve.

Janë shumë çështje që unë i kam cekur shpeshherë në Kuvend, e nuk dua t'i përsëris këtu, por çështja e pakicave duhet të vihet në rrafshin e reciprocitetit. Ne nuk mund ta kemi një situatë specifike të të drejtave specifike gjithmonë për një pakicë, kur në të gjitha shtetet e Ballkanit ka pakica dhe bashkësia ndërkombëtare e Unioni Evropian duhet ta krijojë një standard, të cilit duhet t'i përmban të gjithë.

Kosova duhet të mendojë ta ketë reciprocitetin. Në qoftë se nuk ka zgjidhje të tjera lidhur me pakicat, atëherë ne duhet ta përdorim reciprocitetin për pakicat në Kosovë dhe për pakicat në Serbi dhe marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, në qoftë se nuk mund të zgjidhen ndryshe, do të zgjidhen sipas reciprocitetit. Përndryshe, nuk do të ketë marrëveshje efektive dhe ne do të jetojmë në një botë ambiguitetesh, në një botë pasigurie, në një botë të një konflikti të ngrirë, ku secili do t'i interpretojë marrëveshje sipas dëshirës së vet.

Mendoj se kjo duhet të shikohet më tutje dhe unë kam frikë se po hyjmë në një botë të ambiguiteteve dhe interpretimeve të dyfishta, të cilat do të zgjasin me vite dhe dekada. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Skender Hyseni e ka fjalën.

SKENDER HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Është thënë sa e sa herë në parim se dialogu me Republikën e Serbisë është interes nacional dhe i Kosovës, dhe ky është parim. Dhe, përderisa është interes nacional i Kosovës, ai duhet të ndodhë, mirëpo duhet të ndodhë në pajtim me orientime të qarta strategjike, të cilat i përcakton vetë Republika e Kosovës për veten e vet dhe duhet të ndodhë duke i ndjekur me fanatizëm dhe këmbëngulësi të madhe këto orientime të parapërcaktuara strategjike.

Kryeministri sot na informoi për rrjedhën dhe përmbajtjen e takimit të fundit në Bruksel dhe vuri në pikamë 2-3 momente qenësore nga ky takim.

Një nga ato, do të veçoja unë, ishte ajo që ka të bëjë me përfaqësimin reciprok. Kryeministri i quajti “zyra ndërlidhëse”, ndonjë diskutues tjetër i quajti “zyra përfaqësuese”. Po askush nuk e quajti dhe nuk e kualifikoi këtë moment ashtu si është, pa pasur nevojë që ta zbukurojmë, që ta shndërrojmë në diçka që nuk është. Bëhet fjalë për këmbim zyrtarësh ndërlidhës, nga një zyrtar ndërlidhjeje, të cilët do të vendosen në objektet e delegacionit të Bashkimit Evropian në Beograd. Ndërkaq, në rastin e

Prishtinës, kjo do të ndodhë në zyrat e Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian, në Prishtinë.

Zoti kryeministër, nuk ka asnjë arsye që të pikturohet çfarëdo zgjidhjeje, ose marrëveshjeje, me ngjyrimet, të cilat nuk i ka, sepse vetë fakti i këmbimit të zyrtarëve ndërlidhës është mjaft për fillim dhe është një hap i mirë në drejtimin e duhur. Prandaj, përpjekja për ta paraqitur si diçka që nuk është, vetëm e devalvon, ia humb peshën një hapi të vogël, sado të vogël, por në drejtimin e duhur. Sepse, po bëhen përpjekje për një vendosje të një raporti funksional ndërmjet dy shteteve që dje kanë qenë në luftë, e sot po përpiqen ta ndërtojnë paqen nëpërmjet veprimeve në fillim shumë të vogla, po si do që të jetë domethënëse, dhe interpretimi i saktë e preciz i natyrës së këtyre bisedimeve, vetëm i shton gjasat për sukses në një proces është tepër i ndërlikuar, tepër i vështirë dhe do të marrë kohë.

Më bëri përshtypje po ashtu mospërmendja nga kryeministri e konkluzioneve të Këshillit të Ministrave të Bashkimit Evropian. Duhet të përmenden edhe këto dhe duhet të thuhet që, konstatoj këtu, në këtë drejtim Republika e Kosovës është tej mase retroaktive, në mënyrë të patolerueshme retroaktive.

Bashkimi Evropian po tërhiqet në raste të caktuara përballë të presioneve të Beogradit për gjuhën që përdoret në dokumentet që kanë të bëjnë me Kosovën. U përmend këtu evitimi i përdorimit të togfjalëshit “integritet territorial” dhe kjo ashikare përballë presioneve shumë të qarta të Beogradit dhe këtu do të duhej të ishte momenti kur Qeveria e Republikës së Kosovës të ishte tej mase proaktive dhe insistuese te përfaqësuesja për Politikë të Jashtme dhe të Sigurisë të Bashkimit Evropian, baronesha Ketrin Eshton, sepse është përfaqësuesja e Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe të Sigurisë, që po i ndërmjetëson këto bisedime, e jo baronesha Eshton, siç jemi mësuar t’i themi. Jo në atë cilësi po ndërmjetësohen këto bisedime, por në cilësinë adekuate.

Hapja e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, derisa pritej që do të ketë një vendim që do të mund të ndodhte në qershor, tash qershori përmendet si kohë që do të rivlerësohet sërish dhe shkohet nga një rivlerësim në tjetrin, dhe sërish po them - unë nuk e fajësoj askënd tjetër, pos Qeverinë e Republikës së Kosovës për mungesë proaktivizmi. Në këtë drejtim, Komisionit Evropian, institucioneve të Bashkimit Evropian, nuk u bëhet shumë vonë, ndërkaj Kosovës do të duhej t’i bëhej vonë çdo gjë në këtë drejtim.

Dikush mund të ngushëllohet me faktin se ka një mosdhënie të datave për të gjithë, domethënë nuk është dhënë asnjë datë për askënd. Mirëpo, ne nuk do duhej të ngushëllohemi me dështimet e të tjerëve, kur dështojmë edhe vetë. Ndërkaq, u fol edhe për grumbullimin dhe distribuimin e të hyrave në gjithë Kosovën dhe në veçanti në veri.

Zoti kryeministër, i cili nuk qenka këtu, unë insistoј që dispozitat dhe zgjidhjet që ofron pakoja e Ahtisarit për këtë fushë, të zbatohen me vendosmëri. Aty ka mjaft lëndë, ka mjaft hapësirë, ka mjaft provizione që absolutisht e rregullojnë në mënyrë të kënaqshme këtë.

Dhe, krejt në fund, heqja e strukturave të Serbisë nga veriu. Kryeministri tha se do të bisedohet në janar për këtë çështje. Mirë. Edhe pse Serbia do të duhej ta bënte shuarjen e këtyre strukturave të saj në veri si gjest i vullnetit të mirë, nëse vërtet synon normalizim të marrëdhënieve me Kosovën, por nuk guxon të ketë aranzhime, të cilat i legjitimojnë çfarëdo mënyre ato struktura që janë të Serbisë, për hir të një raporti të shëndoshë e funksional ndërmjet këtyre dy shteteve, edhe në të ardhmen e afërt, edhe në të ardhmen e largët. Të dyja!

Nuk guxojmë të pranojmë zgjidhje që betonojnë në status quo. Nuk guxojmë të pranojmë asnjë lloj zgjidhjeje që nuk zgjidh probleme, por i deponon problemet. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Albin Kurti e ka fjalën

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Më 22 nëntor të këtij viti nuk u lejua që në Kuvendin e Kosovës të trajtohet çështja e veriut të Kosovës, përkatësisht sulmi i asaj dite mbi shqiptarët në lagjen “Kroi i Vitakut”. Veriu në Kuvendin e Kosovës vjen vetëm si veri i dialogut Daçiq-Thaçi, e jo si veri i Kosovës, ku jetojnë shqiptarët më të rrezikuar.

Dialogu me Serbinë, duke qenë vetë kontestim i subjektivitetit tonë, bëhet suspendim i shtet-ndërtimit. Agjendës qeveritare dhe shtetërore në Kosovë i është sipërvendosur ky dialog dhe tash çështjet e Kosovës janë çështje të dialogut. Duke i bërë çështjet e brendshme të Kosovës çështje të bisedimeve me Serbinë, tash këto çështje mund të rikthehen në Kosovë vetëm si çështje të atyre bisedimeve.

Në këtë dialogun politik në Bruksel, Qeveria hyri duke besuar që Serbia do të duket keq aty me Daçiqin që për 8 vjet shërbeu si zëdhënës i Milosheviqit. Mirëpo, ata nuk e kuptuan ose nuk duan ta kuptojnë që pikërisht me këtë dialog po e bëjnë edhe Daçiqin të duket mirë. Kryeministri Thaçi me takimet e tij me Daçiqin po shndërrohet në argument për Qeverinë e Serbisë karshi Bashkimit Evropian dhe atë në argumentin kryesor. Serbia e pandryshuar, që drejtohet nga koalicioni ndërmjet zëdhënësit të Milosheviqit dhe zëvendësit të Sheshelit, bashkëpunimin me Thaçin e ka si atu për ta dëshmuar ndryshimin e saj.

Thaçi beson që po prezanton argumente për Kosovën në dialog në Bruksel, por ai vetë tashmë është shndërruar në argument për Serbinë. Serbia pra e përdor kryeministrin e Kosovës si argument për agjendën e vet. Serbisë po i shtyhet dhënia e datës së fillimit të negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian, duke iu falënderuar kushteve të Gjermanisë, se sa për Qeverinë tonë Serbisë nuk mund t’i vihen pengesa.

Daçiqi ka deklaruar që shumë më të mira i ka marrëdhëniet me Kosovën se sa me Kroacinë, me të cilin ka njohje reciproke. Pra, ju e dini që Serbia dhe Kroacia e njohin njëra-tjetrën, por Daçiqi deklaroi që marrëdhëniet më të mira i ka me Kosovën se sa me Kroacinë. As kryeministri, as presidenti i Kroacisë nuk e pranojnë në takim as kryeministrin e Serbisë Daçiq, as presidentin e Serbisë, Nikoliq, kurse kryeministri i Kosovës, për dallim prej tyre, është në gjendje të përhershme gatishmërie që takohet me

ta, e kryeministrit sot iu bashkua edhe presidentja Jahjaga, e cila i bëri thirrje publike Nikoliqit që të takohen kudo, si të dojë, kur të dojë, e kështu me radhë, kur dihet që ato 80 vota që i ka marrë në këtë Kuvend, nuk i ka marrë në emër të asaj që do t'i bëjë këso ftesa pikërisht në kohën kur duhet të raportojë për punën e saj në vitin e saj në vitin 2012, e jo të na jap premtime e zotime të vjetra për vitin e ri, 2013.

Me këtë sjellje, kryeministri Thaçi po e vë në pozitë të keqe edhe Kroacinë, e cila tash, me këmbëngulësinë e saj që të mos takohet me Serbinë, që e njeh, do të duket një çik më absurde, pasi kryeministri i Kosovës e bën një takim të kollajshëm, të relaksuar, pa kurrfarë kushtesh me kryeministrin e Serbisë, që vjen nga periudha e Milosheviqit, duke qenë edhe dorë e djathtë e tij.

Pra, kryeministri i Kosovës, nëpërmjet këtyre takimeve që po i zhvillon po e sforcon marrëdhënien asimetrike me Serbinë, kur ky dialog politik në Bruksel, që është asimetrik, meqenëse diskutohet për çështje të brendshme të Kosovës, e jo për çështje të Serbisë, dhe ndërmjetësuesi e njeh Serbinë e nuk na njeh neve, po përkthehet në asimetri tash brenda shtetit të Kosovës. Në fakt, asimetria vetëm sa po theksohet, meqenëse plani i Ahtisarit e ka vendosur asimetrinë ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve në Kosovë, me ç'rast Serbia i përfaqësonte në kërkesat e saj dhe serbët këtu. Tash kjo po vazhdohet, pra, edhe më tutje.

E pamë edhe sot në këtë raportim, që më shumë ishte informatë mbi temat e diskutuara, sesa për temat e diskutuara, se do të formohet një njësi e veçantë e Policisë së Kosovës për mbrojtjen fizike të objekteve të trashëgimisë kulturore. Shtrohet pyetja, pse kjo u ideua, u diskutua dhe u dakordua në takim me Daçiqin? Pse nuk u bë këtu në Kuvendin e Kosovës, ose në mbledhjen e Qeverisë? Pse kryeministrit tonë një këso ideje i vjen në mend në takim me Daçiqin dhe pse atje merret vesh pa e diskutuar në Qeveri, pa e diskutuar në Kuvend? Dhe, së dyti, a do të kemi njësi të veçantë të Policisë, njësi multietnike, e cila do ta bënte mbrojtjen e trashëgimisë kulturore shqiptare edhe në Luginën e Preshevës?

Pra, asimetria vetëm sa po thellohet. Arsyeimi banal se na nevojitet që Policia të jetë multietnike sepse ka serbë në Devič, që nuk e dinë shqipen, e tregon nevojën për përkthyes. Kjo nuk e tregon nevojën për njësi të veçantë të Policisë; nëse ka policë që nuk e dinë serbishten, atëherë le ta marrin një përkthyes, që ua mundëson komunikimin me priftërinjtë në Devič dhe në manastiret e tjera, ama nuk ka nevojë për njësi të veçantë të Policisë. Ka nevojë ndoshta për njësi të veçantë të përkthyesve, por jo të Policisë.

Më tej, dialogu në Bruksel dihet që nuk e zbehu aktivitetin, e as shfaqjen e strukturave të Serbisë në veri. Përkundrazi. Por, tash Qeveria e Kosovës është ajo e cila është kufizuar vetëm në kërkesën për transparencë edhe të financave të Serbisë në veri. Transparenca, deputetë të Kuvendit të Kosovës, nuk e ndryshon realitetin, por perceptimin e realitetit. Gjërat janë ashtu siç kanë qenë, mbeten të njëjta, por ne ndryshojmë, si perceptues të tyre. Pra, nëpërmjet transparencës, ndryshimi nuk ndodh te strukturat shtetërore të Serbisë në Kosovë, por te ne që tash arrijmë t'i shohim më qartë ato.

Kërkesa për transparencë është kërkesë për ta hapur dritaren për ta ajrosur dhomën, e jo për ta nxjerrë ujkun nga dhoma. Kërkesa për transparencë, pra, nuk i ndryshon strukturat

ilegale të Serbisë në Kosovë, por përkundrazi na bën që t'i shohim ato (ndonëse nuk është që nuk i kemi parë edhe më herët, e nuk dihet se ku janë ato, me çfarë financash dhe çfarë hierarkie, a çfarë veprimesh bëjnë).

Ne aktualisht po jetojmë në borxh politik me këtë dialog politik. Do ta paguajmë më vonë. Marrëdhëniet po rregullohen ndërmjet Thaçit dhe Daçiçit, e jo ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, dhe jo ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve, jo ndërmjet popullit të Kosovës dhe Serbisë. Dialogu e vulos Serbinë si hisedare për Kosovën dhe nuk e ndryshon realitetin, por e formalizon dhe e legalizon atë. Me këtë dialog po theksohen dallimet brenda Kosovës dhe e përbashkëta e Kosovës me Serbinë.

E, nevojitet ajo që është e drejtë: saktësisht e kundërta e kësaj. Ne kemi nevojë ta theksojmë të përbashkëtën e qytetarëve të Kosovës dhe dallimin e Kosovës me Serbinë. E dëgjuam se edhe presidentja Jahjaga, dy herë e përmendi fjalën diversitet. Pra, mendësia është pikënisja e diferencës që çon te diversiteti dhe te toleranca, në vend se pikënisja të jetë universaliteti, por e përbashkëta, që çon te bashkëpunimi dhe solidariteti. Natyrisht që jam për diversitet, por jo në llogari të solidaritetit dhe mendoj që më e rëndësishme është ajo që është e përbashkët ndërmjet njerëzve, sesa dallimi ndërmjet tyre. Por, është i rëndësishëm dallimi ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

E si bazohemi në të përbashkëtën, në mënyrë që t'i integrojmë serbët në Kosovë dhe të gjithë të tjerët? Me zhvillim ekonomik, me fabrika ku punojnë shqiptarët, serbët, turqit, romët, e kështu me radhë, ku njerëzit kanë se çfarë të fitojnë e çfarë të humbin - ashtu ndodh integrimi. Pra, integrimi nuk mund të jetë vetëm institucional, që vijnë disa deputetë serbë këtu në Kuvend, bëhen ministra. Nuk mund të bëhet integrimi nëpërmjet privilegjeve për politikanët, por integrimi shoqëror që vjen nëpërmjet zhvillimit ekonomik dhe drejtësisë për të gjithë qytetarët. E saktësisht e kundërta ishte ajo çfarë tha presidentja Jahjaga, gjë që paraqet politikën zyrtare edhe të kësaj Qeverie.

Tjetra që desha të them është se a ka procesverbal dhe transkripte, sepse ne nuk i besojmë këtij kryeministri, sidomos pas atyre bisedave telefonike, ku dolën disa preokupime të çuditshme nepotiste, kemi arsye të fuqishme për të mos i besuar. Prandaj, ku janë transkriptet dhe procesverbalet e atyre takimeve që po i zhvillojnë në Bruksel, sepse kryeministri as nuk po raporton si kryeministër, dhe as nuk po raporton si duhet para Kuvendit?

Më tutje, në pikën në Merdar, që ne i themi kufitare, por jo edhe ndërmjetësuesi, pse nuk është flamuri i Kosovës në anën tonë, pse nuk shkruan "Republika e Kosovës" në anën tonë? Flamuri i Kosovës që kryeministri e ka aq shumë për qejf! Nuk është në rregull që flamurin e Kosovës dhe flamurin kombëtar shqiptar t'ia tregojë Sali Berishës. Duhet në Merdar ta vendosë atë. Por, këtë nuk po e bën.

Kur të kalosh prej Shqipërisë në Mal të Zi, për të shkuar në Ulqin, për shembull, aty është integrimi i menaxhuar i kufirit, ku në këtë anë e ke flamurin kombëtar shqiptar, edhe stemën e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Shqipërisë, në anën tjetër e ke të Malit të Zi. Këtu nuk do ta kemi asnjërën.

Dhe, ashtu siç tha z. Hamiti, nuk do të mund të kalojmë me pasaportë të Republikës së Kosovës. Pra, po përhapen mashtrime, manipulime nga më të ndryshmet, në mënyrë që të vazhdojë dialogu...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Edhe një minutë!

ALBIN KURTI: ...në përgjithësi, IBM-ja e relativizon kufirin. Pse nuk e bëmë ne IBM-në së pari me Shqipërinë? Te kufiri me Shqipërinë, në Vërmicë, ekziston edhe flamuri i Kosovës, edhe i Shqipërisë. Pse aty nuk e bën integrimin e menaxhuar të kufirit dhe ta heqim flamurin e Kosovës? Pse këtë po e bëjmë me Serbinë? Dhe, tjetra, neve na konvenon që ta zbutim kufirin, ta zëmë Shqipëri-Kosovë dhe Shqipëri-Mal i Zi, ku janë shqiptarët. Por, gjithashtu, na konvenon që ta forcojmë kufirin me Serbinë, në Merdar. Me këtë rast duhet theksuar që me Serbinë kemi nevojë për një kufi të plotë dhe klasik, i cili vetëm kur na njeh Serbia relativizohet, e jo ta relativizojmë pa e forcuar atë njëherë. Pra, edhe një herë po them, në këtë menaxhimin e integruar të kufirit, që i themi ne, por ndërmjetësuesi nuk e quan ashtu, aq më pak Serbia, nuk e ke as flamurin e shtetit, nuk e ke as “Republika e Kosovës”.

Prandaj, nuk është mirë që Qeveria, për interesa të veta të ngushta, ta gënjejë krejt opinionin se po bën diçka të mirë për shtetin, kur ky nuk është rasti. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Gashi e ka fjalën

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Pas diskutimeve që u dëgjuan, u trajtuan shumë çështje dhe u ngritën shumë dilema dhe ndryshime për çështjet që u raportuan, apo u thanë nga kryeministri i vendit. Ndër temat më të rëndësishme ishte edhe diskutimi i zotit Hamiti, i cili pati edhe replika dhe kundër-replika dhe besoj që ishte me rëndësi. Mirëpo, unë do t’u qasem në diskutimin tim disa problemeve tjera te retorika dhe diskutimet e kryeministrit qysh nga fillimi i bisedimeve me Serbinë dhe unë e kam bërë një kronologji të ndryshimeve të retorikës të kryeministrit, të cilën po e përsëris.

Kryeministri në fillim të bisedimeve tha se bisedimet me Serbinë do ta hapin rrugën Kosovës për integrim në Bashkimin Evropian, pastaj e ndryshoi kur e pa se kjo nuk po ndodh, tha: “Bisedimet me Serbinë do të çojnë në liberalizimin e vizave të Kosovës drejt Bashkimit Evropian”. As kjo nuk ndodhi, e ndryshoi dhe tha: “Bisedimet me Serbinë do të ndikojnë në shtrirjen e autoritetit të Kosovës dhe do të krijojnë kushte për shtrirjen e autoritetit të institucioneve të Kosovës në veriun e Kosovës”. As kjo nuk ndodhi dhe sot retorika ndryshoi.

Kryeministri tha se bisedimet me Serbinë do ta konsolidojnë shtetin e Kosovës. Konsolidimi i shtetit të Kosovës nëpërmjet diskutimeve me Serbinë. Tash po hyj dhe po i analizoj të gjitha një nga një. Integrimet në Bashkimin Evropian, ku është Kosova në

raport me Bashkimin Evropian? Ajo çka Këshilli i Ministrave i Bashkimit Evropian mbrëmë tha, ishte shumë e rëndë për Kosovën. Një goditje direke, apo një shuplakë për institucionet e Republikës së Kosovës, sidomos për kryeministrin e vendit.

Çka po synon Kosova? Kosova po synon që me Bashkimin Evropian t'i ketë raportet e stabilizim-asociimit, raporte të cilat shtetet fqinje i kanë pasur me Bashkimin Evropian para 10 vjetëve. Në bisedimet me Serbinë ne po synojmë të mbërrijmë ku shtetet e rajonit kanë qenë para dhjetë vjetësh dhe Bashkimi Evropian mbrëmë na tha “jo”, sepse Kosova nuk i plotëson kriteret dhe kriteret e Kosovës duhet të jenë të matshme dhe duhet të maten faktikisht me pasojat që prodhohen, sidomos në fushën e sundimit të rendit dhe të ligjit dhe luftën kundër korrupsionit, sepse Bashkimi Evropian nuk i beson Kosovës, apo institucioneve të saj, se janë të gatshme, se kanë vullnet apo kanë kapacitete për ta luftuar krimin dhe korrupsionin.

Te liberalizimi i vizave nuk ka progres, ai mungon. Kushtet janë rritur, bile kemi kushte speciale. Siguria e dokumentacionit, fatkeqësisht me aferën e korrupsionit për tenderin e pasaportave e ka rrezikuar shumë sigurinë e dokumentacionit; krimi i organizuar, korrupsioni dhe elementet tjera përsëriten edhe këtu.

Integrimi i veriut - Çka po na sjellin negociatat në aspektin e integrimit të veriut? Nga ajo që u diskutua këtu dhe që po diskutohet çdo ditë në çdo familje të Kosovës, kemi pak a shumë këto informacione: qasje speciale për veriun, fonde speciale për veriun, njësi të veçanta, se e veçanta mendoj që është edhe speciale, por po thuhet që do të ketë njësi të veçanta policore për monumentet kulturore apo fetare, dogana dhe fondet që mbledhen në kufi, të kenë qasje speciale edhe të investohen në pjesën e veriut dhe elementet tjera, të cilat realisht nuk po ndikojnë në integrimin e veriut, por po krijojnë autonomi për veriun.

Çështja që u diskutua sot dhe u prezantua për herë të parë, të paktën në diskutim publik, apo në diskursin publik, është konsolidimi i shtetit të Kosovës. Shteti i Kosovës po konsolidohet nëpërmjet bisedimeve me Serbinë. Si po konsolidohet shteti i Kosovës? A po konsolidohet shteti i Kosovës nëpërmjet krijimit të fondeve speciale, doganave speciale, TVSH-së speciale, që do të lihet për serbët e veriut. Me njësi speciale të Policisë? Besoj se kështu nuk konsolidohet shteti i Kosovës. Kështu krijohet autonomi e zgjeruar në territoret e caktuara të shtetit të Kosovës.

Po flitet se ka konsolidim të Kosovës, apo po tentohet të prezantohet si konsolidim i Kosovës, por unë besoj që nuk është. Besoj që Kosova duhet të jetë më e fokusuar në aspektin e mbrojtjes së interesave të veta. Besoj që Kosova nuk duhet të synojë nënshkrimin e Marrëveshjes të Stabilizim-Asociimit si fazë fillestare, të cilën vendet e rajonit e kanë kaluar para dhjetë vjetësh, por duhet të synojë integrimin në Bashkimin Evropian dhe të trajtohet si partner i barabartë. Unë i kuptoj vështirësitë. E di që ka vështirësi se shumë vende nuk e njohin Kosovën. I di këto probleme dhe i pranoj si probleme reale, me të cilat përballet Qeveria e Kosovës, mirëpo të mos prezantohen bisedimet me Serbinë si integrim evropian, si liberalizim vizash, si integrim i veriut, apo si konsolidim i shtetit.

Kjo nuk është rruga për ta prezantuar ngjarjen që po ndodh. Kjo nuk është e ardhmja e Kosovës.

Prandaj, mendoj se duhet të kemi qasje më transparente sa i përket qasjes speciale, e cila është e pashpjeguar qartë. Mendoj se duhet të ketë transparencë më të madhe sa u përket fondeve speciale. Mendoj se duhet të ketë transparencë më të qartë dhe më të madhe sa u përket doganave, sa i përket TVSH-së së mbledhur në kufi dhe plot elementeve tjera. Dhe sidomos organizimit dhe strukturave të Policisë dhe njësive të veçanta, siç po quhen, apo speciale, sepse e veçanta unë mendoj se është po ashtu speciale dhe këto elemente duhet të sqarohen të paktën deri në këtë pikë ku kemi arritur, sepse besoj që ditët e ardhshme dhe takimet e ardhshme do të sjellin plot ngjarje të reja. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kryeministri kërkon sqarim shtesë. Zoti kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Parlamentit, Haliti!

Këto që i tha zoti Gashi, të gjitha nuk janë në përputhshmëri me dokumentet që janë në fuqi të Republikës së Kosovës, do të thotë janë të paqëndrueshme. Është interpretim i lirë, prandaj nuk dëshiroj të merrem me to, ndërsa këto që tha i zoti Kurti, dëshiroj ta sqarojë opinionin edhe një herë. E di se jeni shumë i zhgënjyer edhe sot, edhe i frustruar, sepse deri para pak ditësh flisnit që Kosovës do t'i ndodhë ndarja. E harruat, sepse u varros një herë e përgjithmonë ajo ide e Serbisë. Dhe, do të dëshironi që ta shfrytëzoni për poenë politikë.

Flisnit deri para pak ditësh për autonomi. E harruat, sepse nuk do të ndodhë kurrë. Jeni zhgënjyer. I frustruar, sepse ai premtim apo ai zë i zhurmshëm që i prezantoi dhunshëm qytetarët e vendit, ju dështoi, siç ju kanë dështuar të gjitha idetë e mëhershme.

Flisni për status special. E harruat, sepse nuk do të ndodhë kurrë. Ndërsa sikur flisni me garanci të plotë se do të ndodhë ndarja, autonomia ose statusi special dhe ndarja e Kosovës apo autonomia apo status special për serbët në veri. E di se jeni i dëshpëruar, por sido që të jetë, qytetarët e Kosovës janë më të gëzuar se kurrë ndonjëherë.

Tjetër? I përmendët përkthimet sa i përket njësisë veçantë të Policisë. Ajo do të jetë një njësi e veçantë e policisë multietnike. E theksova edhe më herët, që do të përbëhet prej policëve shqiptarë, serbë, boshnjakë, turq, siç e kemi edhe policinë multietnike dhe të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës. Por, me respektin më të madh për të gjithë njerëzit përkthyes të botës së përkthimit, ju e dini se keni dështuar edhe në këtë botë, duke qenë një përkthyes i keq i zyrës së simbolit kombëtar Adem Demaçi, në vitet '98-'99.

Flisni për procesverbalet. Është një transparencë e plotë e këtij procesi para gjithë spektrit politik, qytetar dhe Kuvendit. Nëse dëshironi të mbani procesverbale, jeni njëri nga deputetët e "Vetëvendosjes", do të jeni të lirë të mbani procesverbale.

Flisni shpesh për shqiptarët jashtë Kosovës, qoftë në Maqedoni, qoftë në Preshevë, qoftë në Mal të Zi, megjithëse ata në Mal të Zi nuk i përmend kurrë. Qëndrimi im është shumë i qartë për të drejtat e shqiptarëve, edhe në Maqedoni, edhe në Preshevë. Unë kam theksuar fuqishëm edhe e ritheksoj edhe sot: shteti i Kosovës gjithmonë do të jetë gardian i mbrojtjes dhe i avancimit të të drejtave të shqiptarëve në Maqedoni dhe shteti i Kosovës do ta respektojë gjithmonë vullnetin e shqiptarëve për të ardhmen e tyre në Preshevë.

Ndërkaq flisni për flamurin kuq e zi. Urdhëro, shko në vendlindjen tënde në Vlladimir, ngrite flamurin kuq e zi! Po, as aty nuk shkon. As aty nuk shkon! Prandaj, mos pretendo, mos shit patriotizëm këtu, kur nuk mund të shkosh as në vendlindjen tuaj për ta bërë një gjë të tillë.

E përmendni Daçiqin si argument. Të gjithë i dinë argumentet, punën dhe përkushtimet e secilit nga ne. Po, është e vërtetë: unë e kam luftuar Daçiqin dhe e kam mundur, ndërsa ju nëpërmjet derës së Daçiqit jeni futur në politikë. Asnjë të burgosuri politik nuk i është mundësuar ajo çka juve u është mundësuar. Unë kam lobuar për lirin tuaj nga burgu, por ju e dini shumë mirë se të tjerët janë rrahur, torturuar, masakruar, mbytur. Është fat që kjo nuk të ka ndodhur ty, por asnjë të burgosurit nuk i kanë organizuar konferencë për shtyp, për marketing politik, atë që jua ka bërë Qeveria e Daçiqit.

Prandaj, unë kam luftuar dhe e kam mundur, ndërsa ju jeni futur në politikë nëpërmjet derës së tij. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, zoti Kurti.

ALBIN KURTI: Dialogu vazhdon në Bruksel, pra nuk ka përfunduar asgjë. Qëllimi i Serbisë është pasojë e qëndrimit të njëjtë anti-Kosovë dhe antishqiptar, e kjo është autonomia për veriun e Kosovës, ngjashëm sikur në Bosnjë, por ata e kërkojnë ndarjen, në mënyrë që ta fitojnë autonominë, njësoj sikur Milosheviqi që e kërkonte ndarjen e Bosnjës, e në fund e fitoi republikën serbe atje, njësoj edhe Daçiqi po e kërkon ndarjen e Kosovës, në mënyrë që ta fitojë autonominë atje dhe për këtë gjë ju po i shërbeni shumë mirë.

Temat e rënda janë në vitin e ardhshëm. Unë u ktheva prej Brukseli. Tamam më 17 janar e tutje do të flisni për strukturat paralele të Serbisë, se si të legalizohen ato, dhe është e qartë se Kosovën e kërcënon autonomia. Dhe e kërcënoni edhe ju, duke qenë se jeni të gatshëm të jepni gjithçka të shtetit të Kosovës për ta zgjatur edhe pak pushtetin për veten tuaj.

Dhe, njëkohësisht, dua ta keni parasysh një gjë: ju jeni shndërruar në argument për Daçiqin. Ai po ju përdor juve për t'u dukur mirë para Bashkimit Evropian. I ka prishur marrëdhëniet me Kroacinë, sepse Kroacia nuk e pranon në takim, ndërkohë ju e pranoi pa kushte. Serbia nuk po avancon drejt BE-së, duke iu falënderuar 7 kushteve të Gjermanisë, sesa për Qeverinë e juaj, ajo e kishte fituar edhe datën e fillimit të negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Dhe, nuk i thuhet Vlladimir, se ashtu i thonë malazeztë, por i thonë Katërkollë, e unë nuk jam prej Katërkollës, unë kam lindur në Prishtinë e të Katërkollës nuk e kam as babën. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Thaçi!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Pyetja ime ishte shumë direkte. Ju e dini se si ju kanë pritur dhe ju kanë përcjellë në Bruksel. Prandaj, është mirë t'u tregohet qytetarëve, edhe se si ju kanë përcjellë në adresa tjera nga kryeqytetet evropiane, edhe deklaratimet tjera i dini, por nuk po dua të ju rëndojë shumë. Pyetjet e mia ishin shumë aproiritive kësaj radhe për ju, se do të kemi edhe të tjera në të ardhmen. Por, pyetja ime shumë konkrete: Pse flet për patriotizëm kur në vendlindjen tuaj nuk shkon për ta ngritur flamurin kuqezi në këtë 100-vjetor të pavarësisë së Shqipërisë dhe të flamurit kombëtar?

Dhe, në anën tjetër, përsëri e theksoj, pyetja ishte shumë e lehtë: Si organizuat atë konferencë për shtyp për të hyrë në politikë nëpërmjet promovimit të Ivica Daçiqit?

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Gashi, e ka fjalën për replikë.

ARBEN GASAHI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Mua po më duket se çështja po banalizohet dhe po personalizohet tepër në lidhje me interesat apo interpretimet personale. Ajo çka tha zoti Thaçi lidhur me diskutimin tim, është e vërtetë që diskutimi im është interpretim i lirë i një deputeti të Kuvendit të Republikës së Kosovës, i cili ka të drejtë të bëjë interpretime dhe ta japë mendimin e vet, mirëpo faktet ishin të bazuara në diskutimet dhe diskursin e kryeministrit të vendit, i cili kur filluan diskutimet, tha se do të kemi integrim evropian - nuk ndodhi, liberalizim të vizave - nuk ndodhi, integrim të veriut - nuk ndodhi, e sot ndodhi ndryshimi i diskursit dhe tha se do të kemi konsolidim të shtetit, e shpresoj që të ndodhë.

Unë nuk jam i lumtur për asnjërën prej këtyre që nuk kanë ndodhur. Faktikisht, unë po i përmend faktet se çka ka ndodhur, e nuk më lumturojnë faktet pse Kosova ka dështuar, sepse nuk e konsideroj si dështim personal të kryeministrit Thaçi, por e konsideroj si dështim të Kosovës, prandaj nuk jam i lumtur për dështimet që i ndodhin vendit tim, pa marrë parasysh kush është në drejtimin e tij. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Thaçi!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Zoti Gashi, patjetër duhet të të sqaroj diçka. Për çfarë dështimi po flisni? IMB-ja është menaxhim i integruar i kufirit që bëhet ndërmjet dy shteteve dhe ju shumë mirë e dini këtë. Prandaj, të jemi korrektë dhe të sqartë edhe në raport me opinionin publik. Është hera e parë që po vihet kufiri ndërmjet shtetit të Kosovës dhe Serbisë. Ky është realitet që nuk mund ta mohojë askush, pavarësisht divergjencave politike që i kemi. Prandaj, unë mendoj se në këtë drejtim është mirë secili të ndihmojë, se është shumë lehtë për të kritikuar.

Edhe unë pajtohem që ndoshta disa policë kanë mundur të jenë pak më anash, më në të majtë, më në djathtë, më në qendër, por është një standard dhe kriter evropian që ne e kemi obligim dhe do ta respektojmë dhe, ju e dini shumë mirë. Edhe ju, edhe kolegët tuaj. Ndërsa, sa i përket së ardhmes evropiane, unë e theksova: Kosova sot është peng i mosunitetit të vendeve të Bashkimit Evropian në raport me statusin politik. 22 vende e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, 5 të tilla ende jo. Kosova nuk është ajo që bashkon dhe e mban të bashkuar familjen evropiane. Prandaj, ne jemi evropianë. Përpiqemi dhe punojmë maksimalisht për integrim sa më të shpejtë, por Kosova edhe është e zhgënjyer, edhe është peng dhe viktimë.

E ritheksoj edhe një herë, sepse e kam përcjellë edhe nëpërmjet ambasadorit të Bashkimit Evropian në Bruksel, edhe te baronesha Eshton, edhe te zoti Fyle, se defekti qëndron në mosunitetin e vendeve të Bashkimit Evropian në raport me Kosovën dhe diçka e tillë ka qenë edhe më herët dhe ju shumë mirë e dini, apo të themi më mirë ende si Kosovë jemi duke i paguar kostot historike të dëmshme kundër Kosovës dhe shqiptarëve.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Aliu e ka fjalën.

LIBURN ALIU: Para se të filloj, do të doja të them që shqiptarët edhe në Preshevë, edhe në Maqedoni, edhe në Mal të Zi, janë të shtypur. Në Mal të Zi ata nuk kanë të drejtë ta ngrenë flamurin e vet. Në Mal të Zi ka të burgosur politikë që janë katolikë, e janë të akuzuar për fundamentalizëm islamik. Dhe, në këtë të njëjtin Mal të Zi, kur ata i shtypin, e bëjnë këtë duke i lidhur dhe shtrënguar duart edhe me qeveritarët tanë.

Në Preshevë, po ashtu, njëjtë dëbohen e arrestohen çdo ditë, madje shqiptarët edhe vriten. Kjo ndodh paralelisht, duke u shtrënguar duart ndërmjet Daçiçit dhe Thaçit, edhe përpara, vazhdimisht nëpër negociata, paralelisht me këtë ndodh shtypja e tyre. Situata e njëjtë është edhe në Maqedoni, ku vriten shqiptarët, e në vrasjen e tyre shpeshherë, në njëfarë mënyre, ose involvohet Kosova, ose i përkrah ato. Të mos e harrojmë vrasjen e Harun Aliut. Ai është vrarë në një furgon të mbyllur dhe pas asaj vrasjeje, një lloj “përsëritjeje” i ka shkuar edhe nga Qeveria e Kosovës, respektivisht nga ministri i Punëve të Brendshme. Pra, ju mund të valoni flamuj vetëm më 28 Nëntor, por në fakt edhe flamurin, në fakt edhe të drejtat e shqiptarëve gjithandej nëpër Ballkan, ku shtypen, në njëfarë mënyre i promovoni që ata të shtypen.

E sa i përket Marrëveshjes për IBM, gradualisht po na del kapuç me mëngë. Njëherë u arrit ajo në takimet e fundit të dialogut, që atëbotë Thaçi e Tahiri e kishin pagëzuar si teknik, përkundër gjithë të tjerëve që e dinin atë si politik. Pastaj nuk u zbatua për shkak të refuzimit të Serbisë. Prapë u bë tema kryesore në dialogun, të cilin edhe Thaçi tash po e pranon se është politik ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Dhe, meqenëse u diskutua prapë, ajo u ndryshua dhe doli të jetë diçka tjetër, madje edhe prej asaj që ishin marrëveshje fillimisht Tahiri e Stefanoviq dhe të cilin Tahiri e Thaçi e promovonin si arritje të madhe dhe fitore të pakontestueshme e Kosovës. E tash kjo po ndryshon. Fitore për kë është kjo?

Kur u arrit marrëveshja në secilën përpjekje të mjerë për ta mbrojtur atë, qeveritarët e dialogut flisnin zëshëm për referencat që kjo marrëveshje ka në Traktatin e Lisbonës.

Kjo, pra, na thoshin këta qeveritarë që janë ulur këtu prapa, është dëshmi e qartë e shtetësisë së Kosovës, për shkak se në traktate ndërkombëtare hyjnë vetëm vendet sovrane. Kjo shpërfaq tepër qartë injorancën juridike të këtyre njerëzve. Traktatet nuk janë obliguese për palët që nuk janë nënshkruese të saj. Traktati i Lisbonës nuk vlen për vendet që BE-ja nuk i njeh. Është e njëjtë për shembull me monedhën, si ne që e përdorim euron, e kjo nuk ka të bëjë fare as me Traktatin e Mastroiit, as me Bankën Qendrore Evropiane, e nuk jemi pjesë e marrëveshjeve që bëhen në lidhje me politikën monetare, sikundër asnjë vend nuk ka detyrimin që të ketë me ne marrëdhënie të bazuara mbi këto marrëveshje me Kosovën.

BE-ja nuk e ndalon asnjë vend që t'i kopjojë konceptet e saj juridike apo ekonomike, e po ashtu nuk e ndalon asnjë vend që t'i përdorë termet që janë saktësuar në traktatet e saj. P.sh., po të dojë edhe Maroku, mund të përdorë çfarëdo lloj termi apo rregullimi të ngjashëm me ato të BE-së, por kjo nuk e detyron asnjë vend që të ketë marrëdhënie sipas këtyre traktateve me të. Po kështu, kjo nuk do të thotë që BE-ja po na njeh shtetin, pse ne duam t'i përdorim rregullimet që përmban Lisbona. Për më tepër, meqenëse statusi juridik i Kosovës nga BE-ja nuk pranohet të jetë i definuar përfundimisht, atëherë ky Traktat i Lisbonës ekziston vetëm si dije mbi një koncept, e jo si normë juridike. Pra, nuk e obligon as BE-në që ta njohë si traktat të vlefshëm me të gjitha dispozitat juridike në rastin e Kosovës, e as shtetet anëtare të BE-së.

Në fakt, ne nuk kemi marrëveshje të IBM-së, që nënkupton Menaxhim të Integruar të Kufirit, sepse në marrëveshje ky IBM përkthehet si “pika të kalimit”, pra nuk kemi fare të bëjmë me çështjet e kufirit dhe, në fund të fundit, nuk mund të ketë një IMB të vërtetë pa demarkacion. Nuk mund ta menaxhojmë në mënyrë integrale kufirin e përbashkët, pa e ditur ku është kufiri. E në rastin tonë nuk ka demarkacion pa njohje nga Serbia, që do të nënkuptonte edhe njohje të kufijve shtetërorë të Kosovës. Pra, së pari duhet të na njohë Serbia. Ky edhe ishte kushti që e kërkon Lëvizja “Vetëvendosje” para çfarëdo dialogu me të. Për më tepër, marrëveshja për IBM, meqenëse është marrëveshje për kufijtë, dhe marrëveshje që e prek territorin, duke përfshirë edhe pikat që i përmenda, sipas Kushtetutës do të duhej të ratifikohej për ta fituar fuqinë juridike. Kjo marrëveshje e Thaçit me Daçiçin, e paratifikuar siç është, është e pavlerë dhe e pazbatueshme, që i bie që Thaçi, Bajram Rexhepi e Bedri Hamza, që kanë pranuar ta zbatojnë marrëveshjen, ta kenë shkelur ligjin, për shkak se po e zbatojnë një marrëveshje të paligjshme.

Por, tash këtu e kemi edhe një problem tjetër, që iu shtua kësaj marrëveshjeje në takimin e fundit: ndarja fiskale e territorit të Kosovës. Si pjesë e marrëveshjes për zbatimin e IBM-së na doli të jetë edhe marrëveshja për lirimin nga dogana për serbët e Kosovës, si dhe dakordimi për kalimin e 70% të mjeteve të TVSH-së, që mbledhen nga pikat në veri për strukturat e serbëve të veriut. Ky lloj aranzhimi nuk besoj se është pjesë e Traktatit të Lisbonës, përveç se nëse Thaçi e ka përpiluar një version të tij të ri të këtij traktati në nene shtesë e që në ato raste Kosova do të mund të kishte aranzhime të tilla fiskale që privilegjojnë një pjesë të popullsisë duke e liruar nga tatimi dhe që e ndajnë territorin në dysh duke e liruar atë pjesë nga tatimi dhe duke garantuar alokim të veçantë të mjeteve buxhetore për atë pjesë.

Dhe te kjo ndarje, pikërisht këtu, qëndron shkelja që i bëhet Kushtetutës. Dhe i bëhet madje edhe atij plani të tyre të Ahtisarit, të gjitha rezolutave të Kuvendit e kështu me radhë, sepse ky aranzhim fiskal është në fakt 6-pikëshi i famshëm. Ai 6-pikësh që Thaçi e pati shpallur të vdekur atëbotë, tash e ngjalli me ndihmën e Daçiqit ose në ndihmë të Daçiqit. Dhe, është e natyrshme që tani kur e konsideroni planin e Ahtisarit si kompromis të dhimbshëm, por të pranueshëm e jo si aranzhim të padrejtë e të papranueshëm, ju tashmë keni dhënë sinjale se pak më shumë dhimbje do të pranoni po ashtu.

Dhe kjo dhimbje po shtohet nga pak e vazhdimisht. E keqja është se dhimbja në fakt po i shtohet popullit të Kosovës, ndërkohë që ju jeni ata që e pranoi atë pa dhimbtë. Dhe tërë kjo po na thuhet vazhdimisht se është për rrugëtimin e Kosovës drejt BE-së, sepse e morëm dritën jeshile për studimin e fizibilitetit dhe tash presim Marrëveshjen për Stabilizim-Asociim. Por, kjo nuk erdhi edhe përkundër premtimeve të mëdha se do të nisen negociatat për te shumë shpejt.

Në rrugëtimin tonë drejt BE-së, jo vetëm që nuk kemi përparuar, por kemi shënuar regres. Për shembull, në raportin e mëhershëm, BE-a fliste për integritetin territorial të Kosovës, kurse në konkluzionet e tashme e ka hequr fare këtë përkufizim kur flet për Kosovën. Pra, BE-ja nuk e sheh të garantuar një gjë të tillë për të qenë 100% rehat të flasë për të.

Po një tjetër gjë, ndodhi këto ditë, në raport të BE-së dhe Kosovës. Natën e ndarjes së Çmimit Nobel për Paqe, i cili këtë vit i takoi BE-së, kryesuesi i Komitetit Norvegjez, ndër konfliktet e pazgjidhura e renditi edhe Kosovën, statusin e së cilës e konsideroi si të pazgjidhur. Aty ishin krerët e BE-s dhe nuk pati reagim nga ta. Duke e konsideruar veten si neutral karshi statusit, vërtet BE nuk ka si të mendojë ndryshe, pra ta shohë pavarësinë e Kosovës, si çështje të mbyllur për shkak se ky nuk është propozim neutral. Shtoja kësaj edhe zellin Thaçit e Tahirit për t'ia hequr Republikës fjalën Republikë dhe për ta kthyer në 1244 me fusnotë. Kjo vetëm sa ia fuqizon neutralitetin BE-së.

Shtoja kësaj pastaj deklarime te pamatura dhe të pamençura të Thaçit se nuk pret njohje nga Serbia, atëherë vërtet është të bindësh një shtet, shumë vështirë do të jetë që ta njohë Kosovën. E në këtë pikë këtu, deklarimet që Thaçi i bëri publike pas takimit me ministrin e Punëve të Jashtme të Britanisë së Madhe, Wiliam Hague, ku thotë se nuk pret njohje nga Serbia, Thaçi në fakt e shkel me të dy këmbët edhe Deklaratën e Pavarësisë, këtë që thoshte se ka platformë për negociata. Sepse, Deklarata e Pavarësisë, pikërisht e thotë të kundërtën, që kërkon njohje nga secili shtet dhe tash Thaçi po na thotë se nuk pret njohje bash nga secili shtet.

Kur të thuash se nuk pres njohje, në njëfarë mënyre, ti je pajtuar me mosnjohjen dhe kjo është në kundërshtim me nismën dhe kërkesën që të ketë njohje. E kur e dëgjojnë këtë të tjerët, për shembull: Spanja, Sllovakia e Greqia, do të thonë: mirë, pra, nuk po ju njohim.

Një mendësi politike e cila krejt procesin e shtet-ndërtimit e ka reduktuar në njohjet që vijnë nga jashtë, tash përnjëherë thotë se nuk na duhen njohjet nga jashtë. Kështu kësaj Qeverie nuk i ka mbetur asgjë tjetër. Prej shtrirjes së sovranitetit ka hequr dorë moti,

faktorin e brendshëm më shumë përqendrohet ta heshtë dhe dëmtojë se sa ta mobilizojë e afirmojë, ekonominë ta tjetërsojë, e territorin ta reduktojë.

Kjo qeveri është qeveri e negociatave, dhe mbetet në pushtet vetëm për to. Dhe nuk ishte e rastësishme se si vendimi i parë që e mori në momentin e mandatimit si Qeveri “Thaçi 2”, ishte emërimi i Edita Tahirit si shefe e negociatave. Pra e filloi me negociata dhe nuk bëri asgjë tjetër përveç në rrafshin politik, për t’ia hapur dyert Serbisë dhe privatizoi pronën publike për t’i mbushur xhepat e vet.

E nga këto negociatat e fundit, të cilave nuk po ia shohim as platformën, sepse në fakt prezenca e Thaçit në këto negociata është më shumë e natyrës formale, sepse këto negociata po i bie të jenë në fakt negociata mes Serbisë dhe BE-s, e ku Thaçi njëkohësisht është vetëm nënshkrues dhe zëdhënës i këtyre negociatave.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hamza, për replikë.

BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,

Deputetë të nderuar,

Nuk e di, dhe nuk dua të merrem me paragjykimet e zotit Aliu, se ai flet shumë edhe për të ardhmen, mirëpo unë e kam për obligim t’ju informoj juve deputetë të nderuar dhe të gjithë qytetarët e Kosovës, se me datën 10 dhjetor ka filluar implementimi i Marrëveshjes për Menaxhimin e Integruar të Kufirit.

Të gjithë doganierët e Kosovës, të vendosur në këto dy vendkalime doganore, punojnë dhe funksionojnë mbi bazën e legjislacionit i cili është unik për tërë territorin e Republikës së Kosovës. Të gjitha ligjet, mbi bazën e të cilave punojnë doganat e Kosovës, janë të aprovuar në Kuvendin e Kosovës.

Për informatën tuaj, në vendkalimin doganor në Merdar janë 4 oficerë doganorë të Kosovës dhe 1 oficer doganor i EULEX-it, i cili ka mandat monitorues.

Që nga data 10 dhjetor, deri më tani, në vendkalimin doganor në Jarinje, janë evidentuar 32 dërgesa. Nuk do të thotë që janë të gjitha maune, mund të jenë edhe automjete të kapaciteteve më të vogla ku struktura e këtyre mallrave është kryesisht ushqimore.

Ndërsa në vendkalimin doganor në Merdar janë evidentuar 318 maune. Vlen të theksohet se në përputhje me planin e veprimit, hartuar së bashku me EULEX-in, duke pasur parasysh mandatin e tyre, mallrat me akcizë nuk lejohet të hyjnë në vendkalimet doganore në Jarinje. Të gjitha mallrat me akcizë duhet të hyjnë në vendkalimin doganor në Merdar apo te Dheu i Bardhë.

Kjo procedurë është zbatuar edhe në të kaluarën, në këto dy vendkalime doganore në Jarinje dhe Bërnjak, për mallra të cilat i nënshtrohen tatimet e akcizës.

Me fillimin e implementimit të Marrëveshjes së Integruar të Kufirit, jemi të kënaqur. Rezultatet e para janë pozitive, marrëveshja ka filluar të implementohet ashtu siç është paraparë.

Dogana e Kosovës është duke bërë evidentimin e mallrave në regjistrin e doganave dhe udhëzimin e tyre për doganim, në përputhje me dispozitat e Kodit të doganave dhe akcizës në terminalin doganor në Mitrovicë. Analogji e njëjtë përdoret edhe për mallra të cilat hyjnë në vendkalimin doganor në Pejë dhe gjithashtu edhe në Merdar.

Palët në dialogun teknik janë pajtuar për vendosjen sa më të shpejtë të bashkëpunimit të Doganës së Kosovës dhe Doganës së Serbisë, që të ndihmojnë në shkëmbimin e të dhënave për mallin që eksportohet, përkatësisht importohet në të dy vendet. Kjo, padyshim që do të ndikojë në luftimin e evazionit fiskal, në ndërtimin e dokumenteve përcjellëse të mallit, që ka ndodhur në të kaluarën, për shkak të distancës së madhe hapësinore që ka ekzistuar në mes dy doganave. Kjo do t'i ndihmojë zhvillimit të ekonomisë sonë, do t'i inkurajojë investitorët e huaj për të investuar në Kosovë dhe që është më e rëndësishme, do t'i mbrojë qytetarët e Kosovës nga mallrat që do të kontrollohen tani e tutje.

Prandaj, doganat e Kosovës janë në zbatim të plotë të ligjit. Të gjitha ligjet mbi bazën e të cilave punojnë doganat e Kosovës, janë të aprovuara nga Kuvendi i Kosovës dhe askush nuk ka autoritet që t'i ndërrojë ligjet, në përjashtim të Kuvendit. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Tahiri, replikë.

EDITA TAHIRI: Faleminderit, deputet Aliu!

Marrëveshja e IBM-së dhe protokollit teknik janë në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjet e Kosovës për IBM-en dhe se në marrëveshje dhe në protokollin teknik tekstualisht thuhet se të dyja shtetet veprojnë me juridiksionin e tyre të veçantë.

Pra, unë do të ju kisha inkurajuar, dhe ju lutem, lexoni edhe një herë, shkoni pikë për pikë dhe do të shihni se është fjala për zbatimin e plotë të Kushtetutës dhe ligjeve të Republikës së Kosovës.

E dyta, marrëveshja e IBM-it dhe zbatimi i saj, që filloi të hënën, në fakt e mbyll çështjen e kufirit. Ne e dimë, po edhe ju e dini, se 13 vjet ka pasur porozitet, nuk ka pasur kontroll, ka qenë pra situatë krejt e qartë joligjore në kufirin ndërshtetëror mes Kosovës dhe Serbisë dhe me këtë marrëveshje në fakt vendoset kufiri dhe de facto Serbia e ka njohur, jo vetëm integritetin territorial të Kosovës, por edhe sovranitetin e shtetit të Kosovës.

Po, më lejoni t'ua përmend disa kontradikta që dolën nga diskutimi juaj. Ju thatë se Traktati i Lisbonës nuk vlen për Kosovën, se Kosova nuk është anëtare dhe menjëherë doli kontradikta tjetër, që Kosova zbaton euron. E pra, sipas logjikës tuaj, Kosova nuk ka mund të zbatojë euron, meqenëse s'është anëtare. Po ja që Kosova e zbaton euron prej përfundimit të luftës, prandaj, mund të zbatojë edhe Traktatin e Lisbonës.

Më lejoni të vazhdoj tutje. Ju thatë se nuk mund të ketë marrëveshje IBM mes shtetesh kur nuk ka demarkacion. Unë po ju njoftoj, por këtu e kemi edhe ministrin e Punëve të Brendshme, Marrëveshja e IBM-së ndërmjet shtetit të Kosovës dhe shtetit të Malit të Zi...

(Ndërprerje na regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Aliu, kundër-replikë.

LIBURN ALIU: Së pari do të doja të them që kjo marrëveshje e IBM-it, po e quajmë IBM, realisht nuk është Marrëveshje e Menaxhimit të Integruar të Kufirit, sepse në marrëveshje definohet qartë se ai nuk është kufi, por pika e kalimit. Këtu e keni pranuar këtë marrëveshje, kështu.

Tjetra, për sa i përket zbatimit, ne mund t'i zbatojmë ato çka dalin nga Traktati i Lisbonës, por BE-a nuk ka obligime ndaj nesh dhe nuk ka absolutisht as në lidhje me uron kurrkush obligime ndaj nesh që ne e përdorim euron, dhe jo nga paslufta, por nga koha prej momentit të parë kur ka dalë euro.

Pra, ne mund të zbatojmë dhe të marrim parime të tjerëve, por meqenëse nuk kemi marrëveshje me ta, ata nuk kanë obligim ndaj nesh. Kaq.

KRYESUESI: Bajram Rexhepi, e ka fjalën për replikë!

(Ndërhyn Edita Tahiri)

Jo, jo s'ka replikë. Po, ti e bërë replikën dhe ai ka të drejtë në kundër-replikë dhe kështu përfundon. Zoti Rexhepi, e keni fjalën.

BAJRAM REXHEPI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Shumë gjëra Edita i shpjegoi dhe unë po ashtu nesër e kam një pyetje, nga deputetët e "Vetëvendosjes" në çfarë baze ligjore është bërë menaxhimi i integruar i kufirit dhe tri pyetje tjera në lidhje me ngjarjet që kanë ndodhur në Maqedoni, kështu që nesër do t'i përgjigjem pyetjeve.

Ndërsa, këto janë përgatitje për sistemin e integruar të Shengenit dhe, si e tha Edita, do të vazhdohet edhe me Maqedoninë, me Malin e Zi e Shqipërinë. Pra, të gjitha këto janë synime tona.

Ndërsa për ta shpjeguar pak më në detaje menaxhimin e integruar të kufirit, është pak proces shumë i komplikuar, duhet një gjysmë ore për t'iu shpjeguar çka domethënë.

KRYESUESI: Kundër-replikë, zoti Aliu.

LIBURN ALIU: Sa i përket demarkacionit, duhet të definohet ku është kufiri, që të mund të vendoset pika kufitare. Pra, është e domosdoshme të kesh demarkacion për të ditur ku është kufiri. Për me Malin e Zi, po e shohim, se Mali i Zi është futur 5 kilometra në

brendi, s'e ka bërë kurrkush, pra, në njëfarë mënyre ka filluar të pranohet futja 5 kilometra brenda në territor e Malit të Zi në rrugën Kullë - Rozhajë, në rrugën Pejë - Rozhajë në Kullë, prandaj edhe në këtë rast, natyrisht që do të bëhet pika e caktuar e kufirit, ne duke i pranuar ndërhyrjet e Malit të Zi në kuadër të territorit të Kosovës, sepse nuk ka pasur asnjë lëvizje atje.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti kryeministër, a doni të sqaroni më tutje?

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Të sqaroj dhe plotësoj.

Përsëri këtu u dëgjuan zëra dhe opinione krejt të paqëndrueshme, apo argumente të paqëndrueshme.

Përsëri u fol për shqiptarët që nuk janë pjesë aktualisht e Kosovës, përsëri u përmendën shqiptarët edhe në Preshevë, edhe në Mal të Zi, edhe në Maqedoni.

Unë dëshiroj të theksoj se një pjesë të madhe të kontributit tim jetësor, kombëtar për çlirimin e Kosovës dhe demokratizimin e saj, por një përkushtim të veçantë në jetën time e kam pasur edhe për të drejtat e shqiptarëve në Maqedoni, dhe ndihem shumë krenar, por edhe për të drejtat e shqiptarëve në Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc. Por, kurrë ndonjëherë, në udhëtimet e mia, në qëndrimet e mia, në angazhimet e mia, në aktivitetet e mia dhe të bashkëveprimtarëve dhe bashkëluftëtarëve: në Preshevë, Medvegjë e Bujanoc, Liburn s'ju kam takuar.

Prandaj, ju ftoj, shkoni dhe angazhohuni, do ta shihesh kontributin tim dhe të shtetit të Kosovës.

Por, si do që të jetë, sot secili prej nesh, ju pyet juve personalisht - cili është kontributi juaj personal? Për kontributin në Kosovë, tregoj unë dhe të tjerët, që e njohin shumë mirë.

Ju e dini se kur filluan vitet 1992, 1993, 1994, 1995, 1996, veprimet e para operative kundër ushtrisë dhe policisë serbe, jeni përpjekur edhe ju, dhe e çmoj atë vullnet tuajin dhe atë entuziazmin tuaj, që të jepni atë kontribut, ndoshta atë entuziazëm të krijuar nga filmat, por ju e dini, realiteti është ndryshe dhe kur u ballafaqove me realitetin, pasi që ke zënë pritë, tregoj qytetarëve dhe këtyre deputetëve, këtij Kabineti qeveritar, të gjithëve, qysh je lagur, qysh je shkuar në mal e ke fshehur armën dhe iu ke dorëzuar policisë së Serbisë, pastaj diskuto për çështje tjera.

Dëgjuam edhe prej liderit tuaj, zotit Kurti, për fat të keq nuk do të dëshiroj të dëgjoj prej asnjë deputeti, që e mohon vendlindjen. Unë nuk ju thashë që nuk jeni shqiptar, por ju thashë që jeni nga një vendbanim shqiptar që krenohet secili nga ne. Dhe ai që e mohon vendlindjen, mos harro, e mohon edhe atdheun. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, zoti Aliu.

LIBURN ALIU: Unë nuk do të doja të hyj në elemente fyese. Sa i përket arrestimit tim, unë jam arrestuar në shtëpi. Nuk kam pasur armë, nuk ka pasur mal në afërsi, në Ulpianë nuk ka mal. Nuk ka pasur ato, që i thotë ai.

Le të flasë ai vetë për largimin nga Kosova, menjëherë dhe futjen e tij tek pas 1998-shit në Kosovë.

Unë nuk jam që ta fshij dhe mohoj kontributin e të tjerëve, por unë mendoj që kjo politikë pikërisht po i fshin dhe një nga një po i largon e po i dënon të gjithë ata që kanë kontribuar për Kosovën.

Të mos e harrojmë një gjë, që edhe në të kaluarën shumë kolegë tuaj, kanë ra nëpër burgje, rëniet e tyre nëpër burgje, ka pasur, Afrim Zhitia ka rënë në burg, herën e parë, herën e dytë është vrarë, nuk është kapur i gjallë. Ka rënë Hasan Prishtina në burg, ka rënë Idriz Seferi në burg. Serbët i kanë zënë. Nëse ju...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haziri e ka fjalën.

(Ndërhyrje)

Jo, jo, s'ka replikë. Po kujt ia ka përmendur emrin? Po, Liburnit. Atëherë, Lutfi, vazhdo, e nëse ia ka përmendur emrin ia jep fjalën edhe Albinit për replikë.

LUTFI HAZIRI: Pra, tash po vazhdojmë për kufi, tash, kryeministër. Dhe po vazhdojmë prapë te kufiri, duke qenë i vetëdijshëm për gjendjen kushtetuese që e ka Kosova dhe mandatin politik që ia ka dhënë ky Kuvend Qeverisë, ne mund të konstatojmë që njëanshëm i kemi shpallur kufijtë e Kosovës. Disa nga fqinjët tanë i kanë pranuar, disa s'i kanë pranuar ende.

E natyrshme që IBM vjen si pasojë e përcaktimit të kufijve dhe si finalizim i marrëdhënieve mes dy vendeve, duke i eliminuar apo duke hyrë në një proces të largimit të kufijve në familjen evropiane, e jo duke i forcuar ata.

Po, me veçoritë që i kemi, edhe kësaj here e kemi filluar këtë proces duke e vendosur së pari IBM si proces të menaxhimit të integruar të kufirit, e më vonë duke e lënë krejt në fund procesin e përcaktimit të kufijve, sepse procesi i normalizimit domosdo do të përmbillet me përshkrimin e vijës kufitare, me demarkacionin e plotë të vijës kufitare mes Kosovës e Serbisë.

Dhe nëse bëni sot protokoll me Malin e Zi edhe me shtetet tjera, praktikisht do të vijë në Kuvend ratifikimi, sepse demarkacioni është proces jo i lehtë, dhe në rastin e Maqedonisë ne kemi parë që kushti që Maqedonia ta njohë pavarësinë dhe shtetin e Kosovës, ka qenë të njihet kufiri, jo ai kufiri i vitit 1974, por kufiri si pasojë e marrëveshjes apo nënshkrimit të marrëveshjes Milosheviq-Gligorov, marrëveshje e cila ka shkuar në

ratifikim në OKB dhe marrëveshje e cila duhet të rishitet një gjendje, kur Kosova pak a shumë forcohet.

Krejt shtetet, kuptimin e kanë kur luftojnë për njerëzit e vet dhe për territoret ku jetojnë ata njerëz dhe natyrisht se unë e kam ndarë mendimin tim prej Grupit Parlamentar që i takoj, pra prej LDK-së, jo prej politikës së LDK, po unë besoj që kryeministri i Kosovës duhet të ketë guxim që interesat e qytetarëve të vetë në këtë proces, t'i finalizojë në fund, që e nënkupton zgjidhjen e problemit dhe përcaktimin e vijës kufitare në interes të shqiptarëve dhe të atyre që jetojnë këtu, duke i zgjidhur problemet, e jo duke e prekur apo cenuar, sepse i kemi bërë të shenja parimet tash, por duhet në fund të përmbyllim procesin me një përkrahim apo demarkacion të plotë të kufirit ku shqiptarët shumicë në lindje të Kosovës do t'i kthehen vendit të vet, atdheut të vet, se s'kanë atdhe rezervë, dhe pjesa tjetër të zgjidhet, të zgjidhet në kuptimin politik, sepse në fund normalizimi i marrëdhënieve për Serbinë ka kuptim kur i merr do interesat të veta dhe interesat e veta kanë qenë territoret e Kosovës, s'kanë qenë qytetarët e Kosovës, sepse qytetarët e Kosovës i ka luftuar, ku keni marrë pjesë edhe ju. I ka luftuar dhe në mënyrë me aksioneve luftarake i ka përzhënë prej Kosovës, por është tjetër çka që kemi arritur të rikthehemi dhe angazhohemi.

Këtë duhet pranuar, sepse loja me togfjalësh tash që e tha zoti Hyseni, se e ka pranuar apo nuk e ka pranuar, në mënyrë indirekte Daçiçi e ka pranuar rolin tuaj si kryeministër i një vendi të pavarur. Por, këtu nuk është kryer puna. Është pranuar në mënyrë indirekte, por luftën po e vazhdon për të nxjerrë diçka nga krejt ky angazhim.

A e kemi filluar specifikisht normalizimin e marrëdhënieve si vend? Po. Sepse vendet e ish- Jugosllavisë kanë kërkuar proces krejt tjetër të normalizimit të marrëdhënieve pasi që Komisioni i Banditerit dhe proceset tjera i kanë përcaktuar të drejtat e tyre dhe pjesëmarrjen në pasurinë e vendit, nga krijesa që s'ka ekzistuar, por natyrisht ata krejt janë pajtuar që trashëguese e ish- RSFJ-së apo e Jugosllavisë të jetë Serbia. Edhe kjo është bërë pa neve, praktikisht.

E tash, për të mos hyrë krejt në këtë angazhim, unë mbes besnik dhe i angazhuar që çështja e tri komunave shqiptare në lindje të Kosovës të zgjidhet drejt. Unë e di që mund të argumentoni se Kushtetuta duhet të ndërrohet fillimisht, por në këtë proces politik, në fund do të vjen deri te ndryshimi i Kushtetutës, por e mira do të ishte ky ndryshim të jetë pozitiv dhe në interes të Kosovës.

Unë nuk shoh rrezik tjetër, pos rrezikun e defunksionalizimit të shtetit tonë, me tendencë që i ka Serbia, por deri tash, edhe në procesin e Rambujesë, edhe në procesin e Vjenës, kemi dalë fitues. Besoj se duhet ky proces t'i eliminojë edhe gabimet që i kemi bërë në Vjenë. "Gabime", sepse kemi bërë transaksione të dhembshme për ta fituar 17 Shkurtin. Ne e kemi fituar 17 Shkurtin. Ahtisari e ka mbyllur misionin e vet më 17 Shkurt, përkatësisht me përmbylljen e pavarësisë së Kosovës.

Mbikëqyrja e pavarësisë ka qenë, për mua, përfundim i emrit dhe misionit të madh. Ai do të mbetet në histori në Kosovë, do të mbetet në histori edhe në politika globale, por sa i përket Kosovës, ajo detyrë nga Kosova është realizuar 100%.

Ne nuk mund t'ua imponojmë të drejtat që ua kemi dhënë me zor, kur ata i refuzojnë t'i pranojnë, por këto të drejta duhet ruajtur si vlera që Kosova ua ka ofruar.

Edhe ato, kompromise të dhimbshme në Vjenë, mundësisht t'i eliminoni sikur që Vjena i ka eliminuar disa kompromise të dhimbshme në Rambuje.

Ky proces nuk përfundon as me këtë mandat, por do të ishte mirë që angazhimi i gjithë neve të jetë në mbështetje të përmbylljes së këtij procesi sa më shpejt dhe më drejt.

Unë e ruaj të drejtën ta them vazhdimisht, se e besoj që atëherë kur kanë vendosur ta marrin Preshevën e Bujanocin për ta vendosur në rrethin e Vranjës dhe Leposaviqin e Zubin-Potokun ta vendosin në rrethin e Mitrovicës, kanë qenë politikisht të motivuar dhe ai sherr i asaj date të pas Luftës së Dytë Botërore, po na përcjell edhe sot. Është koha për t'u përmirësuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kurti, replikë.

ALBIN KURTI: Faleminderit!

Kjo logjika e flamurit në vendlindje, është mendësi e bajraktarizmit, e feudalizmit, është mendësi shumë e lashtë, e cila s'ka të bëjë me shtetin modern dhe me kombin si formacion socio-historik modern.

Edhe një herë po e përsëris, unë kam lindur në Prishtinë, vendlindja ime është Prishtina, nënën e kam prej një fshati të Gollakut, që është në komunë të Prishtinës, babën e kam prej një fshati të anës së Malit, që është komuna e Ulqinit, por ky fshat nuk është Katërkolla, të cilin kryeministri po e quan si malazezët, Vlladimiri.

Më tej unë po e shoh që kryeministri qenka mbushur shumë kundër meje. Zëvendësi i tij më ka ftuar në takim. Unë i thashë, po. Në debat televiziv, eja aty edhe shprallohesh, sepse paske shumë gjëra të pathëna.

Pra, i frustruar jeni ju, jo unë. Ju kontrolloni disa televizione dhe disa moderatorë, caktojeni cilindo prej tyre, kur të doni, mund të bëjmë debat dhe mos t'ua marrim kohën deputetëve me këto gjëra.

Dhe, së fundi, nuk është me rëndësi të mos dorëzohesh fizikisht, por mentalisht, intelektualisht dhe emocionalisht.

Jo vetëm deklarimi im para gazetarëve në burg, por edhe në gjyq, edhe i Liburnit në gjyq, edhe në gjyqin në UNMIK, edhe në gjyqin në EULEX, pra, ne nuk e kemi dorëzuar mendjen asnjëherë, ndërkaq ju e keni shpëtuar veten fizikisht, keni shkuar në Zvicër, por

mendjen e keni dorëzuar, keni bërë pakt me djallin, e ne pakt me djallin s'bëjmë kurrë. Faleminderit!

KRYESUESI: Atëherë, zonja Tahiri dëshiron të sqarojë diçka shtesë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRJA EDITA TAHIRI: Lidhur me problemet që kanë ndodhur në kohën e UNMIK-ut dhe një marrëveshje mes Serbisë e Maqedonisë, është e vërtetë që kanë ndodhur, por vetë fakti që ka ndodhur edhe demarkacioni i kufirit mes shtetit të Kosovës dhe shtetit të Maqedonisë, i cili është ratifikuar në këtë Parlament dhe e keni votuar ju vetë, zoti deputet, me këtë është përmbyllur çështja e kufirit Kosovë-Maqedoni. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, zoti Haziri.

LUTFI HAZIRI: Unë vetëm e përmenda si fakt, që përkundër krejt këtyre zhvillimeve, post festum kemi pranuar diçka që kemi qenë të kushtëzuar. Dhe të gjithë ne e dimë që emrin kushtetues të Maqedonisë dhe kufirin e kemi pranuar këtu para votimit të Deklaratës së Pavarësisë.

Ky ka qenë kompromis i madh, por mos harroni se sot kufiri me Serbinë si pasojë e asaj marrëveshjeje është afër lumit Morava dhe në rrugën e Karaçevës së Epërme, ka zbritje. Kosova i ka humbur vargmalet e saja sepse ka marrë kompensim Serbia, të territorit për atë iu ka dhënë Maqedonisë. Ky kompensim herëdokurdo duhet të shihet si kompromis i dhembshëm dhe duhet zgjidhur problemin në parime tjera, që vendosen mes Kosovës dhe Serbisë, jo më me Maqedoninë, sepse nëse Serbia i ka dhënë territor Maqedonisë, komunë ose kishë të rëndësishme, ka dhënë e ka marrë, ka qenë interes i tyre. Por, interesi jonë është në fund, që gradualisht ta përmirësojmë, jo të çojmë kërcënim në Maqedoni. Unë nuk e kam përmendur asnjëherë, e nuk e përmend asnjëherë. Raporti me Maqedoninë është raporti i fqinjësisë së mirë dhe kjo është diçka që ne kemi punuar vazhdimisht njëanshëm, por jo në marrëveshje me këto shtete respektive.

KRYESUESI: Zoti Hydajet Hyseni e ka fjalën.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Nuk e kam ndërmend të zgjatem, megjithatë po më kujton ky debat, sidomos këto të fundit, një fjalë të një plaku të urtë që thoshte: "Çka kam thënë vjet po më qeshet e nganjëherë po më vjen marre sivjet".

Uroj që të mos na ndodhë kjo vazhdimisht. Nuk e quaj të nevojshme këtë mënyrë të gjuaftjes me fjalë e me batuta, në një çështje për të cilën ne do të duhej të ishim bashkë.

Është një anekdotë, të cilën e keni dëgjuar për dy veta që kishin dalë në treg. Njëri shiste, thotë, arra, po arrat i kishte vetëm në krye të shportës, poshtë e kishte të mbushur me gogla. Dhe, tjetri shiste gjëja duhan, e duhanin e kishte vetëm mbi shportë, por poshtë e kishte dushk. Dhe, meqë qëlluan afër, thotë: "Qysh i shet ti arrat, shportën dhe dushkun?"

Thotë: “komplet si është”. Dhe, u morën vesh shpejt dhe secili ikte në drejtimin e vet, i bindur se ia ka hedhur atij tjetrit. Dhe, prej kësaj ka mbetur ajo: “dushk për gogla”.

Dikush e tha këto ditë, në këtë procesin e modernizimit edhe të anekdotave, se thotë jo përfaqësuesve të nivelit të lartë, po dikujt më poshtë i paska ndodhur edhe tani atje me këtë famshmen IBM. U kanë dhënë dikujt një shportë me IBM dhe secili ka ecur në drejtimin e vet duke menduar që është IBM ndonjë laptop i fjalës së fundit të teknikës, kurse në fund, pastaj kanë gjetur, thotë që në njërin prej tyre ishte “B” do të thotë “border” dhe ata e festonin si “border”, por në tjetrën thotë “B” do të thotë “bondori” që është...

(Ndërhyrje)

Po, “bondari”, faleminderit, Lutë! Po, po më qeshet sivjet. Dhe, në të vërtetë, thotë në të tretën çantë ishte “B”, do të thotë “blof”, që do të thotë: intelligent blof manipulation. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Lama e ka fjalën.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryesues!

Ajo për të cilën do të flas tani është në lidhje me atë që e quajmë Menaxhim i Integruar i Kufirit, ç’është ky proces?

Së pari më lejoni që në fillim të them se po shpërndahej shumë mjegull. Së dyti, më lejoni të them që Evropa po bën një eksperiment në lidhje me këtë, në kufijtë mes Kosovës dhe Serbisë, kufij që i quajmë ne, por Serbia nuk i konsideron.

Po bën një eksperiment, sepse nuk di se si ta zgjidhë këtë konflikt, e ka futur Kosovën në një proces, fundi i të cilit nuk dihet.

Menaxhimi i Integruar i Kufirit nënkupton automatikisht besimin ndërmjet dy shteteve. Kjo, menaxhimi i integruar i kufirit, është faza e fundit në të cilin dy shtete mund të bashkëpunojnë, pra, fillimisht duhet që të ketë mirëbesim mes tyre, të mos ketë atë çfarë po ndodh mes të Kosovës e Serbisë, të mos ketë agresivitet, sepse këtu kemi të bëjmë me një gjë shumë të rëndësishme, me sigurinë, me shkëmbimin e të dhënave. Ç’është menaxhimi i kufirit? Është një kufi, janë dy posta kufitare, njëra e njërit shtet dhe tjetra e shtetit tjetër, ku secili shtet pranon t’i shkëmbejë të dhënat me shtetin tjetër. Dhe për këtë nevojitet mirëbesim. Natyrisht ky është një proces shumë pozitiv, sepse në radhë të parë lidhet me lehtësimin që u bëhet qytetarëve për të kaluar, por edhe të mallrave. Pra, për të mos pasur dy kontrole, por për të realizuar një kontroll në mënyrë që të shkurtrohet edhe koha edhe të lehtësohen proceset.

A mund ta bëjë Kosova me Serbinë këtë? Besoj që të gjithë jemi të bindur se jo, sepse, së paku me aq sa di unë, ne nuk kemi besim tek shteti i Serbisë. Si mund të kemi besim tek shteti i Serbisë kur ai mban një pjesë të territorit të Kosovës, pra pikërisht në veri, të pushtuar.

E dëgjova kryeministrin që fliste me shumë komoditet në lidhje me forcat speciale të policisë, të cilat do t'i krijojë dhe që do të kenë destinacion pikërisht këto pika kufitare. Unë do të doja t'i dëgjova komentet e tij në lidhje me policët serbë të cilët punojnë edhe për Republikën e Kosovës, edhe për Republikën e Serbisë. Janë me dhjetëra prej tyre që punojnë njëkohësisht për të dy shtetet. Nuk ka shtet në botë që do të pranonte që polici i vet të punojë edhe për një shtet tjetër. Një polic duhet të jetë lojal ndaj shtetit të tij.

Më lejoni ta rikujtoj fundin e procesit, ose të dialogut teknik në të cilin Kosova ishte më përpara këtij procesi, dialog i ashtuquajtur teknik, sepse ishte politik. Me çfarë u shpërblye Kosova dhe me çfarë u shpërblyer Serbia? Serbia u shpërblye me statusin e vendit kandidat. Këtë gjë ia mundësoi Kosova, me pjesëmarrjen e saj në dialog, ndërsa Kosova u shpërblye me një pyetësor prej 110 pyetjesh për liberalizmin e vizave, një pyetësor i cili ka kushte që Kosova nuk do të mund t'i përmbushë për 10 vjet. Pra, u shpërblye me një dokument i cili mund të interpretohet në pafundësi për plotësimin e standardeve dhe të kushteve.

Asnjë vend i rajonit, të jemi realistë, nuk ka pasur një numër kaq të madh pyetjesh. Në fakt, asnjë vend i rajonit, përfshirë edhe Serbinë, nuk është trajtuar në këtë mënyrë, siç u trajtua Kosova.

Të kthehem, gjithashtu, te kufiri. Pse është shumë i rëndësishëm ky proces, të cilin ju thoni se keni arritur marrëveshje? E vërteta është që Evropa nuk pranon shtete që kanë konteste kufitare. Ka pranuar Qipron, por me qindra herë e ka përsëritur që një gjë të tillë nuk do ta bëjë më.

Pikërisht ky fakt është një arsye shumë më shumë që edhe Kosova të insistojë që t'i forcojë kufijtë, pikërisht pra në lidhje me Serbinë, sepse Serbia është vendi agresor.

Është një arsye më shumë t'i forcojë kufijtë dhe të mos lejojë asnjë ambiguitet ligjor dhe as praktik. Ajo çfarë po ndodh në veri të Kosovës, pra kjo mënyrë se si po ndahen kufijtë, thjesht është përfitim në kohë, është zgjatje e ambiguitetit ligjor, sepse jam shumë e bindur që nuk do të mund të funksionojë në rrafshin praktik, ashtu si nuk mund të funksionojë kati i pestë pa pasur të ndërtuar katet tjera. Duhet fillimisht themelet, dhe themelet janë ekzistimi i një kufiri klasik shtetëror.

Dhe, në fund, pas mënyrës se si flitet këtu në Kuvend nga kryeministri, më lejoni t'i them që zoti kryeministër bota po shkon drejt globalizmit. Ju e keni gojën plot integritet në Bashkimin Evropian. Kjo është retorika juaj, edhe pse e dimë që ju nuk besoni.

Pikërisht Evropa është ndërtuar mbi një lloj logjike të super nacionalizmit. Ju e dini këtë. Ndërkohë, ju në anën tjetër promovoni krahinorizmin. Cilat janë bindjet tuaja, të vërteta, zoti kryeministër? Sepse, bindjet e një njeriu që ka në dorë shtetin, pra e ka postin më të rëndësishëm në shtet, janë shumë të rëndësishme. Ne nuk e kemi luksin sot që të udhëheqim shtetin me persona që mund të kenë bindje raciste, për shembull, as krahinoriste, por po supozojmë, nëse i keni të tilla. Pra, bindje të cilat automatikisht

lidhen me të drejtat e njeriut dhe me sa po shoh unë, ju keni bindje shumë të deformuara. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Muja e ka fjalën.

SHAIP MUJA: Unë e kisha përgatitur një fjalim me një radhitje tjetër, por duke parë zhvillimin e bisedimeve dhe duke parë mënyrën se si e afirmojnë disa deputetë vetveten vetëm sa për t'u reflektuar në televizion, më befason mënyra dhe qasja se si e bëjnë.

Një pjesë e opozitës këtu nga "Vetëvendosja" vetvetiu flet shumë për Kosovën, ndërsa nuk i njeh institucionet e Republikës së Kosovës. Rrjedhimisht e kanë eksplotuar vetveten që të flasin për këto institucione.

Në mënyrën e trajtimit të çështjes për IBM, unë mendoj që dita e hënë ka qenë një ditë historike për Kosovën, ka qenë një ditë shumë e madhe e cila nuk u vu shumë në spikamë. Për çfarë arsye? Sepse, që një vit ka që bisedojmë se nuk do të ketë IBM në Republikën e Kosovës.

Unë kërkoja nga sekretaria, në mënyrë origjinale dhe do ta lusë sekretarinë që t'ua fotokopjojnë dhe t'ua japin 8 pika të IBM-së, e t'i lexojnë edhe një herë dhe mbi bazën e këtyre 8 pikave të shohim se çka ka ndodhur ditën e hënë.

Unë do t'ua lexoj vetëm pikën e parë, ku thuhet se në përputhje me Traktatin e Lisbonës dhe legjislacionin relevant të BE-së, e që e ka me sqarim me numër 2, poshtë e keni, sipas BE-së thotë: siç është përcaktuar veçanërisht me Kodin e Shengenit për kufijtë, do të thotë Kodin e Shengenit për kufijtë, Rregulloren e Frontekstit, Rregulloren e trafikut të kufijve lokalë, rregulloren e VIS dhe Kodin e BE-së për vizat. Një standard, i cili sot, secili që lëviz në Bashkimin Evropian derisa ne hyjmë në portën e Bashkimit Evropian, përdoret pasaporta që u shtrua këtu nga disa deputetë, ndërsa po sa hyn në Bashkimin Evropian, t'i kalon vetëm me një leje të njoftimit apo një mjet identifikues i cili është i pranuar nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian.

Mënyrën e togfjalëshit që luhet këtu, se çfarë është arritur, unë mendoj që Qeveria është vërtet duke e irrituar opozitën, dhe keni të drejtë plotësisht, sepse sukseset të cilat është duke i arritur si Qeveri, në drejtimin e stabilizimit, në drejtimin e menaxhimit të sigurisë, në drejtimin e gjetjes së solutioneve, duke bashkëbiseduar me Republikën e Serbisë, në relacion të drejtë dhe duke vu kontakte të cilat janë të padëshirueshme për ta zgjedhur bashkëbiseduesin nga kryeministri i Kosovës, se Daçiçin nuk e ka bërë Hashim Thaçi kryeministër, por e ka bërë populli serb dhe ai është tani përfaqësues i tyre dhe me të duhet të bisedojë, patjetër.

Dhe Daçiçin nuk e ka zgjedhur për bashkëbisedues, por e kanë caktuar dhe ndërmjetësuar Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e ku një pjesë e opozitës janë kundër këtyre koncepteve dhe nuk duhet t'u shihet për të madhe. Ne i humbim që një vit, duke biseduar për lojëra afirmative politike, duke mos pasur identitet të vetëvetshëm një opozitë e cila vërtet është për keqardhje, sepse kualiteti juaj kombëtar nuk mund të jetë

bash në fund të pusit, por edhe nuk jeni ju me qenë flamurtarët apo zëdhënësit e çështjes kombëtare, të Kosovës.

Përfaqësimi me zyre apo me ndërlidhës nëpërmjet kësaj, ka qenë njëra ndër vlerat të cilat sot ka qenë e pamundur të imagjinohet se ne do të kemi një person, pavarësisht se a do të rrijë në zyrën e BE-së, a do të rrijë diku në një zyre të cilën do ta merr me qira Republika e Kosovës, është një thyerje e madhe e akullit, sepse zyrtarisht po pranohet, qoftë përmes ndërmjetësuesve ndërmjetësimi dhe fuqizimi i konsolidimit të shtetit të Kosovës, në raportet ndërkombëtare dhe në njohjen bilaterale në mes dy shteteve.

Në fonde të veçanta për veriun, që quhet, janë fonde të tranzicionet, sepse në veri mbi 12 vjet ata katër liderë që quhen atje nuk janë liderë, sepse vetë reagimi që dje u kthye një maune në veri me alkool dhe reagimi menjëherë i kryetarit të Leposaviqit, tregon se ai nuk e ka interesin serb, por e ka interesin e biznesit, e kriminalitetit ekonomik, e 7 miliardë e gjysmë, të cilët i kanë deportuar për 12 vjet dhe për atë arsye sot ata janë duke e parë një rrezikshmëri dhe në këtë frymë është duke u konsoliduar, qoftë në atë mënyrë a tjetër Republika e Kosovës dhe me të vërtetë opozita nganjëherë e tejkalon arsyeshmërinë.

Në pyetjen për policinë e veçantë, në preambulën e ekzistimit të Ministrisë së Brendshme dhe zoti Gashi e di fort mirë se ka qenë në këto struktura të Ministrisë së Brendshme, Policia e Kosovës është e detyruar të krijojë kohë pas kohe organizma të veçantë mbi bazën e vlerësimit të situatës, qoftë në perceptcionin politik apo të rrezikimit të sigurisë. Dhe këto nuk do të thotë se ato do të jenë të përjetshme, për derisa të krijohet një stabilitet i tillë. Prandaj, nuk ka nevojë të krijohen perceptcione se Kosova apo Qeveria e Kosovës është duke bërë ndonjë lëshim të veçantë.

Mbi të gjitha, është akuzuar Qeveria e Kosovës se a e ka një platformë apo jo, e ne dhe deputetët tanë i kemi përkrahur se platforma është marrëveshja e Ahtisarit, e cila nuk është duke u shkelur por është duke u implementuar dhe pa marrëveshjen e Ahtisarit nuk ka funksionalitet të Kosovës. Andaj, edhe rezoluta e miratuar në këtë Kuvend, duhet të jetë si një pikënisje e cila sot i jep të drejtë kryeministrit për implementimet teknike të veçanta, e të mos na pyet as neve.

Ne nuk kemi nevojë të shohim veprimet teknike të cilat i ka me Kushtetutë kryeministri. Ne duhet të flasim për pjesët dhe është e vërtetë ajo pjesa e marrëveshjeve ndërkombëtare, mirëpo marrëveshja ndërkombëtare e IBM është një marrëveshje ligjore e përcaktuar, ndërsa e miratuar dhe monitoruar edhe nga Bashkimi Evropian dhe e garantuar edhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Unë po ua lë këtë sekretarisë le t'ua ndajë edhe një herë, dhe kisha pasur qejf që krejt ky takim që u bë me kaq shumë bujë, me kaq shumë mënyra të prezantimit, ka mund të përmbyllet me një gjysmë ore, ose me pyetje shumë specifike për kryeministrin, diçka të cilat janë me vlerë për publikun. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, zoti Gashi!

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Unë vetëm desha t'ia jap një sqarim parafolësit se është e vërtetë që Ministria e Punëve të Brendshme, në bashkëpunim me Drejtorinë e Policisë mund të krijojë struktura, sipas nevojës së vet, por po ashtu është e vërtetë edhe një fakt tjetër që unë nuk e thashë se e ka bërë Ministria e Punëve të Brendshme, në bashkëpunim me Drejtorinë e Policisë dhe as kryeministri nuk tha kështu. Kryeministri, të paktën na raportoi që kjo është bërë në bashkëpunim dhe në diskutim me kryeministrin e Serbisë dhe këtu qëndron diferenca e madhe në mes meje dhe parafolësit, jo te fakti pse u krijua një njësi e veçantë apo speciale, por nëse Policia e Kosovës, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme e vlerëson të rëndësishme, le t'i ndërtojë, nuk ka asnjë problem.

Problemi është pse duhet të ndërtohet nëpërmjet procesit të diskutimeve me Serbinë dhe pse duhet të kërkohet nga Daçiqi, pse duhet t'i jepet si koncesion, pse ky koncesion duhet të llogaritet si një dëm për interesat e qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe për shtetin e Republikës së Kosovës dhe plot elemente tjera, dhe jo a ka të drejtë Ministria e Punëve të Brendshme në bashkëpunim me Drejtorinë e Policisë ta bëjë këtë punë a nuk ka. Ka të drejtë Ministria e Punëve të Brendshme, në bashkëpunim me Policinë, por nuk ka të drejtë kryeministri, në bashkëpunim me kryeministrin e Serbisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Kundër-replikë, për një minutë. Zoti Muja!

SHAIP MUJA: Po, faleminderit!

Zoti kryesues, unë papë po kthehem tek ai togfjalëshi dhe të jep përshtypje sikur të thuash në televizion shihni çka po flas unë dhe pa na treguar asgjë.

Kjo mënyrë e cila thuhet pse është bërë me Daçiçin dhe ajo, është e paqëndrueshme. Ministria e Punëve të Brendshme dhe kryeministri është ekzekutuesi apo kryeshërbyesi, ndërsa ministrat ose ministri i Punëve të Brendshme, është shërbyes brenda kësaj strukture të sigurisë. Prandaj, është e obligueshme dhe e panevojshme të diskutohet se në çfarë situatash edhe rrethanash mund të pyesë kryeministri ministrin gjatë bisedimeve të mia me Daçiçin a do të vendosi a jo. Kjo është një diplomaci, ky është një lëshim, normalisht edhe një garantim para faktorit ndërkombëtar që ne nuk do t'i cenojmë as pasurinë fetare, as pasurinë e patundshme të qytetarëve dhe minoriteve tjera...

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Rexhepi e ka fjalën.

BAJRAM REXHEPI: Desha vetëm një sqarim, se shpesh u përmend për njësinë e posaçme, për ruajtjen e objekteve kulturore e fetare, realisht në kuadër të policisë dhe atë të Policisë së Rendit, jo të njërive speciale, e kemi marrë obligimin për shumicën e kishave, të manastireve dhe tjera, dhe pritet shumë shpejt të merret edhe për Patrikanën e Pejës dhe ai kontingjent i policëve që ka punuar është formalizuar, bashkë si dhe Ministria me Drejtorinë e Policisë, natyrisht në konsultim edhe me kryeministrin që të dihen se ata policë që e ka shumicën shqiptarë, por në vende të caktuara ka edhe serbë dhe të komuniteteve tjera, ta kenë si detyrë primare këtë. Pra, specifikohet që të mos ketë shpesh rrotacione, por për shkak të një kontinuiteti dhe të njohjes me përfaqësues që janë

nëpër këto objekte, prandaj është formalizuar një diçka që ka qenë ekzistuese dhe mendoj se kjo çështje është praktike dhe s'duhet ta brengosë askënd.

KRYESUESI: Faleminderit!

Zonja deputete e zotërinj deputetë, zëvendëskryeministra, ministra të Kabinetit të Qeverisë, ju falënderoj për bashkëpunimin dhe për debatin që e kemi zhvilluar dhe me kaq e përfundoj seancën.

Nesër, në orën 10:00 do ta vazhdojmë punën me një seancë të re. Ju faleminderit!

E përgatiti:

Njësia për Transkriptim dhe Lekturë